



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Ekonominë dhe Financat

PROCESVERBAL

Tiranë, më 20.11.2018, ora 10:00

Drejton mbledhjen:

Erion Braçe – kryetar i Komisionit

Rendi i ditës:

1. Miratimi i procesverbalit.
2. Diskutimi i koncesioneve.

Marrin pjesë:

Erion Braçe, Anastas Angjeli, Evis Kushi, Antoneta Dhima, Ilir Xhakolli, Xhevit Bushaj, Arben Pëllumbi, Roland Xhelilaj, Reme Lala, Ismet Beqiraj dhe Sadi Vorpsi.

Mungojnë:

Jorida Tabaku, Blerina Gjylameti, Ervin Bushati Edmond Spaho, Agron Shehaj, Fatbardha Kadiu, Nadire Meçorapaj, Dashamir Shehi, Edmond Haxhinasto dhe Përparim Spahiu.

Të ftuar:

Arben Ahmetaj – Ministër i Financave dhe Ekonomisë

Gelardina Prodani- Sekretare e Përgjithshme në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë

Mimoza Dhëmbi – Drejtore e Përgjithshme në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë

Gentian Opre – Drejtor në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë

Xhoana Agolli – Drejtore në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë

Alda Klosi – Drejtor i koncesioneve në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë

Alba Caroshi – Këshilltare në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë

Arber Lleshi - Këshilltar në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë

Knidi Bashari – Këshilltar në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë

HAPET MBLEDHJA

Sot në rendin e ditës kemi disa çështje.

Së pari, do të vijojmë me diskutimin në parim të projektbuxhetit të shtetit për vitin 2019. E kemi përcaktuar që sot do të diskutojmë për kapitullin e koncesioneve dhe partneritetin publik-privat, efektet e tyre buxhetore dhe respektimin e tavaneve që janë vendosur nga ligji për buxhetin e shtetit.

Së dyti, shqyrtimi i raporteve të komisioneve të përhershme të Kuvendit për diskutimin në parim të projektbuxhetit të shtetit të vitit 2019 dhe më pas votimi në parim i projektbuxhetit të shtetit për vitin 2019.

Së treti, shqyrtimi i raporteve të komisioneve të përhershme të Kuvendit për projektligjet financiare që shoqërojnë projektbuxhetin e shtetit për vitin 2019 dhe natyrisht edhe votimin në parim të secilit prej projektligjeve.

Fillojmë me pikën e parë. Do të procedojmë me prezantimin nga ana e zotit ministër të Financave dhe Ekonomisë dhe pastaj me pyetjet dhe diskutimet lidhur me këtë çështje.

Urdhëroni, zoti Ministër!

Arben Ahmetaj - Faleminderit!

Në këtë seancë dedikuar çështjeve që kanë të bëjnë me koncesionet dhe PPP-të, do të dëshiroja ta filloja fjalën time me atë se çfarë parashikon Ligji Organik i Buxhetit, i amenduar së fundmi në vitin 2016, për Koncesionet dhe PPP-të. E them këtë, jo pa qëllim, sepse ka qenë kjo qeveri, kjo maxhorancë, që në ndryshimin e ligjit organik të buxhetit, ka vendosur dy elemente transparence të rëndësishme për sa u përket koncesioneve dhe partneritetit publik-privat. Pra, është kjo maxhorancë që i ka vendosur vetes dhe qeverive që vijnë, dy standarde të rëndësishme, transparente, ndaj partneritetit publik- privat dhe koncesioneve.

Së pari, dëshiroj të citoj nenin 4/2 të ligjit ku përcaktohet, si më poshtë: "...shuma e përgjithshme e pagesave vjetore neto, që kryhen nga njësitë e qeverisjes së përgjithshme, të cilat rezultojnë nga kontrata koncesionare apo Partneriteti Publik- Privat (PPP), si rregull, nuk duhet të tejkalojnë kufirin prej 5% të të ardhurave tatimore faktike të vitit paraardhës buxhetor".

Së dyti, në po këtë nen, përcaktohet për herë të parë, kjo maxhorancë, kjo qeveri dhe ndërkohë unë isha po në Ministrinë e Financave, se "Kuvendi, në ligjin vjetor të buxhetit, miraton tavanin e vlerës totale të kontratave në përqindje të produktit të brendshëm bruto

(PBB), për të gjitha projektet koncesionare/PPP-të ekzistuese dhe ato të kontraktuara rishtazi gjatë vitit buxhetor korrent”.

Për herë të parë e kthjem në detyrim ligjor, nuk e lamë narrativë të dokudoshme, por e kthjem në detyrim ligjor dhe, për dijeninë e të gjithëve ju, është hera e parë që është bërë një listë e plotë ligjore, një regjistër i plotë i koncesioneve dhe PPP-ve, që nuk ka ekzistuar kurrë. Këtë e kam me qytetarët, gjithashtu, për t’i sqaruar se gjithë debati politik mbi koncesionet, do ta shikoni, për ata që do të na ndjekin sot, për deputetët që kanë nevojë patjetër në legjitimitet për sqarime të mëtejshme, që kjo qeveri e ka rritur transparencën e instrumentit të PPP-ve dhe koncesioneve disa shkallë më lart.

Do t’jua them dhe më vonë në fjalën time, por po e them edhe tani, që gjithë pyetjet, “a janë borxh”, “a nuk janë borxh”, kanë të bëjnë me dy standarde ndërkombëtare, njëri i vendosur nga qeveria e kaluar, me vendim qeverie 575, nga qeveria e Sali Berishës. Standardi i parë është mënyra si kontabilizohen në bazë të ESA 95 apo ESA 2010.

E dyta, e lidhur me të parën, është mënyra e kontabilizimit në bazë të risqeve, risqet e kaluara te privati automatikisht nuk kontabilizohen në borxh.

E treta, ESA 95, të dashur deputetë dhe qytetarë që na ndiqni, është vendosur përpara vitit 2013 si mënyrë kontabilizimi e koncesioneve.

Më vjen keq që nuk është opozita këtu, që t’ia tregoja vendimin 575, t’i thosha: “Ja, ju kur keni qenë në pushtet e keni vënë këtë standard kontabiliteti”. Po edhe ne të maxhorancës ta shohim, standardi i kontabilitetit është vendosur nga qeveria e kaluar. Vendimi 575, ESA 95, mënyrë kontabilizimi jashtë borxhit publik, për shkak të mënyrës së ndarjes së risqeve dhe të pagesave të disponueshmërisë. Këtu mbaron debati, deputete, që pyetët a mund të ishin borxh apo jo (i referohem pyetjes së kaluar, së cilës nuk iu referova plotësisht, se e kishte vënë re dhe opozita që nuk u përgjigja plotësisht dhe sot gjeta rastin që t’ju përgjigjem edhe juve, edhe opozitës, plotësisht).

Si i ka respektuar qeveria këto dy nene të këtij ligji organik? Në relacionin e projektbuxhetit 2019, që është para jush, e keni të evidentuar qartë se për vitin 2019, kufiri prej 5% i të ardhurave tatimore faktike të vitit paraardhës, pra i të pritshmit 2018, respektohet dukshëm, pasi kap një shifër prej 3% të totalit. Dhe, nëse do të shkojmë akoma dhe më tej, me parashikimet përtej këtij viti, në afatmesëm, kapim vlerat në 2020 dhe 2021, respektivisht 3,3% dhe 3,4%

Sa i përket nenit tjetër, në nenin 19 të projektligjit të buxhetit 2019 përcaktohet se: “Tavani për vlerën totale të kontratave në përqindje të PBB-së për të gjitha projektet koncesionare/PPP-të ekzistuese dhe ato të kontraktuara rishtas për vitin 2018, në përputhje

me të dhënat e regjistrit të koncesioneve është 46% e PBB-së.” Regjistri i koncesioneve nuk ka ekzistuar asnjëherë, por e kemi bërë ne. Nuk ka pasur regjister koncesionesh. Nuk dihej fare sa koncesione ishin dhënë dhe kush i kishte, kush nuk i kishte, sa kishte avancuar, sa nuk kishte avancuar.

Këtu dua të bëj një sqarim shumë të rëndësishëm. Gjithë kontratat janë 807 miliardë, të gjitha kontratat, nga të cilat 391 miliardë janë energji, pra janë HEC-e, që ta kuptojnë qytetarët kur dëgjojnë PPP-të, është Ashta, është Devolli, është AYEN Energji, janë ato HEC-et që shikoni poshtë e lart nëpër Shqipëri, janë të gjitha pjesë e kësaj shifre.

Pjesë e kësaj shifre është dhe kolaudimi i makinave, është edhe Rapiscani, janë edhe pullat fiskale, është edhe Regjistri i Barrës Siguruese. Pra, kjo boloria e PPP-ve, duhet sqaruar sot dhe pastaj kuptohet që secili ka të drejtë të bëjë pyetje kur nuk bindet.

Ndërkohë, mbetet një shifër 415 miliardë, nga të cilat 262 miliardë janë të reja që nuk kanë hyrë në fuqi, pra në proces, që do të thotë se mbeten aktive, përtej energjisë, 153,8 miliardë ose 8,7%. Domethënë, atë balonën e fryrë me qëllim, “koncesione-PPP”, ja ku e keni, 8,7%. Dhe 46% e totalit janë energji. Pra, vetëm 8,7% e totalit janë aktive. Pjesa tjetër janë në procese. Kjo besoj ishte një shifër shumë domethënëse për secilin nga ne dhe nga ata që na dëgjojnë.

Me fjalë të tjera, me këtë nen Kuvendi përcakton tavan total në terma realë për të gjitha koncesionet apo PPP-të ekzistuese dhe ato të reja, bazuar në një listë të detajuar që jepet në relacionin e këtij projektligji. Kjo do të thotë që Kuvendi nëpërmjet vendosjes së një “cap” (tavani) qeverisë, ushtron diskrecionin e tij për disiplinimin e këtyre projekteve në çdo ushtrim buxhetor vjetor.

Por përtej këndvështrimit të ngushtë ligjor, që përfshin Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, do të dëshiroja që edhe në përgjigje të kërkesave të këtij komisioni të nderuar, të ndalesha fillimisht në arsyet se pse qeveria që unë përfaqësoj sot këtu, është angazhuar për të jetësuar projekte infrastrukturore dhe ofrimin e disa shërbimeve publike me anë të modeleve koncesionare apo të partneritetit publik-privat:

Pikë së pari, vlера tejet e konsiderueshme për zbatimin e këtyre projekteve (bëhet fjalë për vlера investimi që shkojnë përtej shifrës 1 miliardë Euro).

Zonjë, që jeni deputete e Dibrës, opozita do t’ia mohojë rrugën Dibrës. Opozita kërkon t’ia mohojë rrugën Dibrës. Pra, opozita është duke i thënë popullit të Dibrës që ju do të rrini atje, 25 vjet pa rrugë, sepse ne duhet të bëjmë pak zhurmë për këto që quhen PPP dhe koncesione. Ti që je deputete, në respektin tuaj zonjë që je deputete e Dibrës, të lutem transmetoja popullit të Dibrës, që maxhoranca dhe qeveria e zotit Rama do ta bëjë rrugën me

Partneritet Publik Privat, në favor të zonës së Dibrës. Ne nuk duam që populli i Dibrës të presë 25 vjet, zonjë e nderuar, ne duam që populli i Dibrës ta ketë rrugën sa më shpejt.

E njëjta gjë vlen edhe për popullin e Shkodrës. E njëjta gjë vlen edhe për gjithë zonat e tjera që përfitojnë nga partneriteti publik-privat. Nuk kemi deputetë të Kukësit këtu, por po të ishte opozita, do të kishim deputetë të Kukësit, pra ajo që thonë ata është jo, Rruga e Kombit të mos mirëmbahet. Nuk ka rëndësi që mungon ura, nuk ka rëndësi që mungon sinjalistika, nuk ka rëndësi që ajo rrugë të degjenerohet, nuk ka rëndësi. Pastaj thonë, shiko ne e duam popullin e Dibrës, por duhet ta lëmë pa rrugë, e duam ashtu, që të mos vijë kurrë në Tiranë, të rrijë atje, që të mos venë kurrë nga Tirana, por të ndahet për së gjalli me pjesën tjetër të vendit, të mos bashkohet me rajonin. Duan të dënojnë popullin e Dibrës, zonja deputete, transmetoja në emër të maxhorancës që ne nuk do ta lëmë.

Vlera tejet e konsiderueshme për zbatimin e këtyre projekteve (bëhet fjalë për vlera investimi që shkojnë përtej shifrës 1 miliardë euro), nuk mund të përballohet nga fondet e kufizuara të buxhetit të shtetit për periudhën e kryerjes së investimeve, përkatësisht në kohën e nevojshme prej 2-4 vjet. Gjithashtu, niveli aktual i borxhit publik nuk lejon asnjë hapësirë për marrjen me hua të më shumë se 1 miliardë eurove nga institucionet financiare. Dhe kemi përdorur standardin ndërkombëtar të aprovuar me vendim 575 nga opozita e sotme, maxhoranca e pardjeshme.

Nuk preket niveli i borxhit publik, për sa kohë që Shteti hyn në një marrëdhënie kontraktuale me partnerin privat, e cila implikon pagesa të rregullta ose jo, dhe jo dhënie garancish sovrane për financime nga banka apo institucione financiare të ndryshme;

Skemat e PPP-së mundësojnë futjen e teknologjive të reja dhe metodave inovative në drejtim të ofrimit të shërbimeve më të mira publike dhe të përmirësimit të eficiencës operacionale.

Partneriteti Publik Privat mundëson një impakt më imediat ekonomik, social dhe politik pasi mundëson pasjen e aseteve apo shërbimeve të rëndësishme në një kohë relativisht të shkurtër, gjë e cila nuk mund të bëhet e mundur nëpërmjet procedurave klasike të prokurimit publik dhe kufizimeve të borxhit;

Për PPP-të në shëndetësi, e dini çfarë u thonë qytetarëve që na kanë votuar? Këta i thonë, ti me dializë do të udhëtosh nga Korça, nga Shkodra, nga Dibra, nga Gjirokastra, nga Vlora, në 5 të mëngjesit, do vish të zësh radhën këtu, e ashtu siç je në hall, ti e di, bëj çfarë të duash, se mua nuk më duhet se çfarë bën ti. Kurse maxhoranca jonë vendosi ta bënte ndryshe dhe sot, shërimi i dializës për ata që kanë nevojë, në vuajtjen e tyre, është më i shpejtë, më afër vendbanimit dhe numrat janë të konsiderueshëm të shërbimit.

Dikur ka qenë 80 mijë lekë, kaq u kushtonte, 80 mijë lekë kur bëhej nëpër spitalet publike me ato radhët e gjata ku nisej i shkreti njeri nga Korça e nga Gjirokastra që në 4 të mëngjesit për të kapur 7-n e mëngjesit këtu. 80 mijë lekë kushton dhe tani, por tani e paguan buxheti i shtetit. Këta i thonë të sëmurëve, u thonë pacientëve që shkojnë në spitale për sterilizimin, “nuk na duhet çfarë ndodh me jetën tuaj, se ne kemi axhendën tonë politike dhe do dalim tani të flasim për PPP-të”. E s’ka ngelur njeri pa folur për risqet e PPP-ve e as e dinë fare se çfarë përfaqëson një partneritet publik-privat.

Këto PPP ofrojnë një efikasitet më të lartë në përdorimin e fondeve, sidomos në projektet e Infrastrukturës, pasi risku i ndërtimit i alokohet 100% partnerit privat. Gjë që nuk ndodh në rastin e prokurimit klasik publik, ku projektet e infrastrukturës si në rrugët nacionale, shkollat apo infrastrukturën shëndetësore.

Dhe për arsyen që sapo përmenda, do të dëshiroja t’ju tregoja juve dhe publikut disa shembuj projektesh tipike të rrugëve nacionale, pasi shembujt janë me dhjetëra dhe kam një listë të gjatë me vete, por doja të veçoja disa prej tyre si më domethënës:

Rruga Tiranë – Elbasan, kontraktuar fillimisht në vitin 2011 me vlerën totale prej 303,9 milionë dollarë, dhe deri në këtë moment kjo vlerë është tejkaluar me rreth 100 milionë dollarë. E mbani mend hapjen e rrugës? Gati 30% më shumë dhe më flasin këta për risk PPP?! Dhe ne i dëgjojmë patjetër, se e kemi detyrë dhe kënaqësi, e hall ndonjëherë, t’i dëgjojmë. Rruga Tiranë-Elbasan nisi me 304 milionë dollarë. Ka shkuar 405 milionë deri më tani dhe nuk ka mbaruar. Nuk ka mbaruar zonjë, që ju ka votuar Elbasani pasivisht. T’ia tregoni këtyre, që risku në logjikën e tyre, te koncesionet të bëra pa mendje, pa zemër, dhe pa projekt, përfundon në këto shifra që ju them unë. Dhe më interesantja, nëse çertifikohen pretendimet ekstra deri në këtë moment, në kohë kapin vlerën 36 milionë dollarë, atëherë kjo vlerë shkon sipër 41.6% e vlerës fillestare. E kujt i flasin këta për risk të partneritetit publik-privat?! 41,6 % nga një prokurim publik. Një rrugë që nisi me 304 milionë dollarë, do të përfundojë, ta shohim, me 430 milionë dollarë e më shumë.

Aksi Plepa – Kavajë – Rrogozhinë, i startuar në vitin 2008 me një vlerë të kontraktuar prej 2,8 miliardë lekë, më në fund u mbarua në vitin 2018, pra pas më shumë se 10 vjetësh (se u hap me 1 mijë dollarë), është shtuar me rreth 543,7 milionë lekë gjatë kësaj periudhe si shtesa kontrate, ose 20 % e totalit të kontratës. Kalon e gjithë Shqipëria atje, le ta kuptojë që ajo kontratë u bë pa mendje, pa zemër, pa profesionalitet dhe përfundoi me një shtesë kostojo 20%. Kujt i tregojnë këta riskun e PPP-ve?! Ja, fatkeqësisht, nuk janë këtu të dëgjonin.

Aksi Qafë Thanë-Lin-Pogradec, ju jeni deputet i Pogradecit, por pak rendësi ka, aty kalon e gjithë Shqipëria, që ta kuptoni se çfarë i kanë bërë Pogradecit dhe Shqipërisë, ka filluar në vitin 2009 dhe pritet të përfundojë në fund të 2018-ës, është nisur me 2,9 miliardë lekë dhe ka kërkuar 582,6 milionë lekë më shumë ose 20% të vlerës!

Kujt i flasin këta për risk të PPP-ve?! Një kontratë nuk e kanë fiks, ta kenë nisur fiks. E dini se çfarë ndodh me Qukës-Qafë Plloçen? Duhet edhe 52 milionë dollarë, sepse nuk bashkohet aksi i rrugës. Ta dinë qytetarët. Në vitin 2011, kur nisi si fanfarë, nuk bashkohej aksi i rrugës si projekt dhe duhet edhe 52 milionë dollarë.

Ato zonjat që shkruajnë pyetjet, mirë është të mbajnë shënim edhe këto.

Një argument tjetër shtesë që e bën më atraktiv modelin e koncesioneve të partneritetit publik -privat ndaj prokurimit publik, është pikërisht incentiva apo shtrëngimi që i bëhet partnerit publik -privat për ta mbaruar rrugën në kohë.

Mora rastin e Dibrës. Praktikisht, pikësepari në kontratë partneri privat duhet që të ecë deri në 25-30 % të punimeve dhe të paraqesë faturat e para, të cilat e kanë nivelin të paracaktuar. Do të thotë që për 3-4 vjet duhet të ketë investuar plotësisht, pra ta ketë mbaruar rrugën, dhe të marrë maksimalisht dy pagesa disponueshmëri në vitet 2019 dhe 2020. Pra, të ketë investuar afërsisht 170 milionë dollarë dhe të ketë marrë afërsisht 35 milionë dollarë në dy vite, në 2019 dhe 2020, në fund të viteve 2020 apo në 2021 do të ketë dorëzuar rrugën. Pra, dibranët tanë do të kenë rrugën në vitin 2021. Partneri privat duhet të presë 13 vjet të paguhet.

Argumenti i opozitës që do të rëndojë mbi taksat tona është, po e zbus gjuhën, jo korrekt, për të mos thënë ndonjë fjalë të rëndë, sepse çdo investim publik, edhe sot në konkluzionet përfundimtare të FMN, për herë të parë do të quhet investime publike dhe do t'ia mbyllin gojën njëherë e mirë kujt do. Praktikisht, risku i mbarimit të rrugës është mbi partnerin privat.

Partneri privat paguhet për performancë, pra për situacione të certifikuara dhe është nën presion për të mbaruar rrugën në kohë, pasi struktura e financimit të projektit është e tillë që rreth 70-80% e financimit sigurohet nëpërmjet bankave, të cilave partneri privat duhet t'i paguajë këstet e kredisë së marrë për këtë qëllim në kohë, sipas modelit.

Në vijim, do të doja të fokusohesha pikërisht te CV-të e çdo projekti nga lista e 15 projekteve koncesionare që janë kontraktuar apo janë në rrugë për t'u kontraktuar në sektorët prioritarë të vendit.

Aktualisht janë 11 kontrata koncesionare në fushën e infrastrukturës rrugore, shëndetësisë, menaxhimit të mbetjeve dhe arsimit, ndërkohë që janë në finalizim e sipër,

kuptohet që do të ndjekin procedurën zyrtare, e cila zgjat 3 muaj, 6 muaj, 18 muaj, varet nga kompleksiteti dhe nga gatishmëria që ka partneri privat që nis procesin. Duke përjashtuar kontratat e PPP-së në fushën e shëndetësisë, kontratat e tjera koncesionare kanë hedhur dhe pritjet të hedhin në total në ekonomi jo pak, por rreth 134,8 miliardë lekë ose 1,1 miliardë euro. Duke përjashtuar kontratat koncesionare, pra partneritetin publik- privat në shëndetësi janë hedhur 1,1 miliardë euro nga kontratat e tjera aktive. Shumica dërrmuese e këtij totali do të injektohet gjatë viteve 2019-2020, që do të thotë se kemi një nxitës të rëndësishëm për përshpejtimin e rritjes ekonomike për këtë periudhë dhe përtej kësaj. Për të mos folur këtu për numrin e konsiderueshëm të vendeve të punës që do të gjenerohen nga kantieri të ndryshme të këtyre projekteve.

Gjithsesi, për të qenë më konkret, do të marr në analizë të detajuar një për një të gjitha koncesionet dhe PPP-të me pagesa buxhetore që ju janë ekspozuar në relacionin e këtij projektbuxheti, duke u përqendruar tek kostot, përfitimet dhe risqet.

Po e filloj me 11 kontratat ekzistuese, si vijon:

Ministria e Shëndetësisë

Koncesioni PPP-së i shërbimit të kontrollit Bbzë, kohëzgjatja 10 vjet 2015-2024.

Kostoja buxhetore totale e parashikuar për 10 -vjeçarin është 76 miliardë lekë, kostoja buxhetore mesatare vjetore është 6 milionë lekë.

Përfitimet

Në periudhën afatmesme dhe afatgjatë të mund të zbulohen në kohë dhe të parandalohen sa më shumë të jetë e mundur sëmundje, të cilat nëse nuk do të identifikoheshin në kohë, do të sillnin pasoja të konsiderueshme për vetë njerëzit e prekur, por edhe kosto të konsiderueshme për trajtimin e tyre me shërbimet e nevojshme shëndetësore.

Bazuar në të dhënat që vijnë nga përvoja botërore, për shembull nga analiza e kosto-përfitimeve e NHS (Shërbimi Kombëtar i Kujdesit Shëndetësor) në Angli, të vendosura në kontekstin shqiptar, me kurs këmbimi PPP, rezulton se me programin e kontrollit bazë pa pagesë 40-65 vjeç, do të arrihet të kursehen kosto për shpenzime shëndetësore rreth 15,4 miliardë lekë, 125 milionë dollarë, si dhe do të parandalohen 450 vdekje të parakohshme. Jam duke përdorur standardin që përdor Mbretëria e Bashkuar në shërbimin kombëtar të shëndetit të tyre. Pra, jemi duke përdorur të njëjtin standard parashikimi dhe nuk kemi shpikur standard.

Tani, këta duan t'i vënë çmim jetës! Për ne jeta e qytetarëve nuk ka çmim, është më e shtrenjtë se gjithçka e megjithatë, meqë e deshët dhe në terma financiare, me një standard krahasues kursimi ndër vite do të jetë 125 milionë dollarë. Pra, siç mund të shihet qartë,

përfitimi në vlerë monetare mund të shkojë te dyfishi i asaj çfarë pritet të shpenzohet për këtë PPP në 10 vjet.

Vlen të theksohet së një pjesë e kursimit vjen edhe si pasojë e ofrimit të këtij shërbimi nga operatorë privatë, pasi Fondi i Sigurimit Shëndetësor i paguan kontraktorit 1537 lekë, pa përfshirë TVSH-në, e cila transferohet në buxhetin e shtetit. I njëjti protokoll i kontrollit pa pagesë në sistemin publik kushton 5200 lekë, ndërsa në sistemin privat i njëjti shërbim kushton 8000 lekë.

Pra, dua që qytetarët ta dëgjojnë, Fondi i Sigurimit Shëndetësor i paguan 1537 lekë, pa përfshirë TVSH-në, për një *check-up*. I njëjti protokoll në publik kushton 5200 lekë, ndërsa në sistemin privat kushton 8000 lekë.

Risqet

A ka ky partneritet publik -privat risk? Patjetër që ka, është risku i kërkesës, që në rastin e këtij koncesioni, praktikisht ne do të ishim të lumtur që numri që do ta përdornin *check-up*-in të vinte gjithmonë në rritje, në mënyrë që sa më e madhe të jetë pjesa e qytetarëve, e popullatës që përdor *check-up*-in, aq më shumë parandalojmë sëmundje, aq më shumë parandalojmë vdekje të mundshme dhe patjetër pastaj ulim dhe kostot afatmesme dhe afatgjatë.

Koncesioni apo PPP i shërbimeve të integruara, po brenda Ministrisë së Shëndetësisë për ofrimin e setit të personalizuar të instrumenteve kirurgjikale, furnizimin me material mjekësor steril njëpërdorimshme në sallat kirurgjikale, si dhe trajtimin e mbetjeve biologjike, dezinfektimin e sallave kirurgjikale me kohëzgjatje 10 vjet 2015-2025.

Kostoja buxhetore totale e parashikuar është 17 miliardë lekë. Kostoja buxhetore mesatare vjetore është 7 miliardë lekë

Përfitimet

Zëvendësimi i skemës ekzistuese të pajisjes dhe sterilizimit të instrumenteve kirurgjikale dhe dezinfektimin e sallave kirurgjikale, e cila ka rezultuar inefficente dhe inefektive në tërësinë e saj, duke rezultuar me pasoja të konsiderueshme në terma rishtrimi të pacientëve, të cilët kanë kryer ndërhyrje kirurgjikale si pasojë e marrjes së infeksioneve të ndryshme nga pajisjet kirurgjikale, të cilat ripërdoren dhe sterilizohen jo mjaftueshëm, si dhe dezinfektimin jo të plotë të ambienteve.

Evitimi në maksimum i situatave të tilla, të cilat i kanë sjellë shërbimit spitalor kosto ekstra, të cilat nëse do t'i shtojmë këtu dhe koston e sterilizimit të pajisjeve kirurgjikale, dezinfektimin e ambienteve të sallave kirurgjikale që rezultonte në të kaluarën, e tejkalojnë dukshëm koston që Ministria e Shëndetësisë paguan aktualisht për këtë partneritet.

Mjafton të evidentojmë një fakt, që për rishtrimin e pacientëve të konstatuar me infeksione të marra postkirurgjikale, buxhetit të shtetit i duhet të përballojë një kosto mesatare prej 14 mijë lekësh në ditë, për një kohëzgjatje mesatare 5 ditë shtrimi. Duke qenë se gjatë një viti janë kryer mesatarisht rreth 50 mijë ndërhyrje kirurgjikale në spitalet publike dhe minimalisht 20% e pacientëve janë rishtruar për çështje infeksionesh postkirurgjikale, atëherë kostoja vjetore totale nga këto rishtrime ka rezultuar në shifrën mesatare prej 700 milionë lekësh, shifër kjo thuajse e barabartë me atë të parashikuar vetëm për sterilizimin e instrumenteve dhe dezinfektimin e sallave kirurgjikale.

Gjithashtu, ky partneritet siguron dhe një menaxhim sipas standardeve ndërkombëtare të mbetjeve biologjike që rezultojnë nga shërbimi spitalor, pasi në të kaluarën janë evidentuar një sërë problemesh, të cilat kanë rezultuar me menaxhim joefektiv të këtyre mbetjeve dhe ç'është më e keqja me pasoja serioze për mjedisin.

Çfarë risku ka? Risku sërish i kërkesës që mund të lindë si pasojë e nevojave për instrumente kirurgjikale më shumë se sa parashikimi fillestar, por që do të kërkojë një menaxhim të kujdesshëm të këtij risku nga ana e Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale në periudhën afatshkurtër dhe atë afatmesme, pasi pritshmëria është që nëpërmjet reformave të ndërmarra në fushën e parandalimit dhe të zbulimit në kohë të sëmundjeve, si edhe ajo më sipër e *check-up-it*, kërkesat do të jenë brenda parashikimeve të kësaj kontrate.

Po brenda Ministrisë së Shëndetësisë koncesioni i shërbimit të dializës me kohëzgjatje 10 vjet 2016-2025. Kostoja buxhetore totale e parashikuar është 55 miliardë lekë në 10 vjet. Kostoja buxhetore mesatare vjetore është 655 milionë lekë në vit.

Përfitimet

Ofrimi i një shërbimi dinjitoz për pacientët që trajtohen me dializë, duke evituar radhët e pafundme që rezultonin në të kaluarën dhe kalvarin që duhet të kalonin disa prej tyre që jetonin larg qendrave ku ofrohej ky shërbim, ku kishte pacientë që duhet të vinin nga zona të largëta të Shqipërisë në Tiranë, minimumi 3 herë në javë. Imagjinoni dikë nga Saranda, Gjirokastra, Korça, Dibra, Shkodra, të vijë 3 herë në javë në Tiranë, i sëmurë në nevojë për dializë.

Këta diskutojnë PPP-në e dializës, këta që mungojnë sot këtu. Evitimi i kostos së shoqërimit nga familjarë të pacientëve, të cilëve u duhej të ishin domosdoshmërisht me pacientin në këto seanca, duke mundësuar kështu heqjen e një barre shpenzimesh transporti, hoteli, ushqimi për to, apo çdo lloj kostoje që shoqërohet me një udhëtim.

Ofrimi në kohë dhe me cilësi i këtij shërbimi jetik për këtë kategori mundësohet me një kosto për njësi më të ulët se sa rezultonte në rastin kur ky shërbim ofrohej nga vetë spitalet publike.

Dikush nga të opozitës më tha: “Po ç’është kjo që harxhoni kaq shumë lekë, këta shumë pak veta janë?”. E kuptoni ju logjikën? Si ka mundësi kjo pyetje e njërit nga opozita?!

Ne e kemi në programin e qeverisë, ne duam ta përmirësojmë çdo ditë atë moto që ka kjo maxhorancë e majtë, ne nuk lëmë askënd mbrapa.

Vlen të theksohet këtu se në përfundim të këtij partneriteti, shërbimi spitalor do të trashëgojë ambientet e ndërtuara, të rindërtuara nga ofruesi privat, si dhe pajisjet përkatëse me të cilat kryhet ky shërbim.

Risqet

Risku i kërkesës që mund të lindë si pasojë e shtimit të numrit të pacientëve që kanë nevojë për shërbimin e dializës më shumë se sa parashikimi fillestar, por që nuk pritet të impaktojë në mënyrë të ndjeshme buxhetin e FSDKSH-së.

Vazhdojmë me Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë.

Koncesioni i inceneratorit të Elbasanit, me kohëzgjatje 7 vjet 2015-2021. Kostoja buxhetore totale e parashikuar është 6 miliardë lekë. Kostoja buxhetore mesatare vjetore është 662 milionë lekë.

Përfitimet

Nëpërmjet këtij koncesioni, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë synon që të zgjidhë njëherë e mirë problematikën alarmante të ndotjes së mjedisit në qytetin e Elbasanit, duke vënë në dispozicion të bashkisë së saj një incenerator të standardeve bashkëkohore, i cili do të mundësojë jo vetëm trajtimin profesional të mbetjeve urbane të kësaj bashkie, por do të krijojë edhe mundësinë që këto mbetje të gjenerojnë energji elektrike për popullatën. Në fund të periudhës së këtij koncesioni, Bashkisë së Elbasanit i kalohet në pronësi dhe përdorim ky aset i rëndësishëm, i cili jo vetëm që do të përmirësojë dukshëm cilësinë e mjedisit, por edhe do të mundësojë gjenerimin e të ardhurave shtesë, si pasojë e shitjes së energjisë elektrike në sistemin elektroenergjetik shqiptar.

Risqet

Risku i kërkesës, ky risk ka lidhje me depozitimin e sasive të mbetjeve nga ana e Bashkisë Elbasan, që është nën kontroll, pasi kjo sasi është parashikuar brenda projeksioneve aktuale të gjenerimit të mbetjeve nga kjo bashki plus sasitë ekzistuese të akumuluar dhe të patrajuara ndër vite.

Koncesioni i inceneratorit të Fierit, i cili parashikohet të fillojë në vitin 2018, me kohëzgjatje 6 vjet 2018-2023. Kostoja buxhetore totale e parashikuar është 4,5 miliardë lekë. Kostoja buxhetore mesatare vjetore është 753 milionë lekë.

Përfitimet

Nëpërmjet këtij koncesioni Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë synon që t'i japë një zgjidhje të qëndrueshme problemit të menaxhimit aktual të mbetjeve në qytetin e Fierit. Si në rastin e inceneratorit të Elbasanit, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë synon të vërë në dispozicion të Bashkisë Fier një incenerator të standardeve bashkëkohore, i cili do të mundësojë jo vetëm trajtimin profesional të mbetjeve urbane të kësaj bashkie, por edhe do të krijojë mundësinë që këto mbetje të gjenerojnë energji elektrike për popullatën. Edhe në këtë rast, në fund të periudhës së këtij koncesioni, Bashkisë Fier i kalohet në pronësi dhe përdorim ky aset i rëndësishëm, i cili jo vetëm që do të përmirësojë dukshëm cilësinë e mjedisit, por edhe do të mundësojë gjenerimin e të ardhurave shtesë, si në rastin e Elbasanit, si pasojë e shitjes së energjisë elektrike në sistemin elektroenergjetik shqiptar.

Koncesioni i inceneratorit të qarkut Tiranë, i cili pritet të fillojë punimet në 2018, me një kohëzgjatje prej 30 vjetësh. Kostoja buxhetore totale e parashikuar është 39, 1 miliardë lekë, është ndërtim nga privati, nuk është nga buxheti. Buxheti i shtetit për një periudhë afatmesme ka marrë përsipër të subvencionojë bashkitë e qarkut të Tiranës, nëpërmjet Bashkisë së Tiranës, me një kosto rreth 750- 800 milionë lekë në vit, për një periudhë afatmesme. Në një moment të tij, buxheti tërhiqet tërësisht nga subvencioni ndaj bashkive.

Nëpërmjet këtij koncesioni, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë synon t'i japë një zgjidhje të qëndrueshme problemit të menaxhimit aktual të mbetjeve në bashkinë e Tiranës, si në rastin e Elbasanit e të Fierit. Ministria e Infrastrukturës synon të vërë në dispozicion të qarkut Tiranë një incenerator të standardeve bashkëkohore, i cili do të mundësojë jo vetëm trajtimin profesional të mbetjeve urbane, por siç e thamë më lart, do të gjenerojë energji elektrike për sistemin.

Koncesioni BOT HEC mbi lumin Devoll, ku ka përfshirë rimbursimin e ndërtimit të rrugëve zëvendësuese nga buxheti i shtetit, me kohëzgjatje pesëvjeçare.

Kosto buxhetore është 6, 76 miliardë lekë

Kostot buxhetore mesatare vjetore janë 1, 3 miliardë lekë.

Nuk ka nevojë t'i theksoj përfitimet. Në finale, pas ndryshimeve ligjore të këtij koncesioni, të miratuara në vitin 2015, Ministria e Energjisë dhe Industrisë ka synuar që të eliminonte një barrierë serioze, e cila rrezikonte seriozisht investimin më të madh të kryer

ndonjëherë në sektorin elektroenergjetik shqiptar përgjatë këtyre 25 viteve të fundit. Me marrjen përsipër nga ana e kompanisë “Shtatkraft”, të ndërtimit të rrugëve zëvendësuese, të paguara nga buxheti i shtetit mundësohet akses i komuniteteve, të prekura nga ndërtimi i veprave hidroenergjetike nga kjo kompani. Gjithashtu, theksojmë faktin se qeveria e kaluar e kishte ndërmarrë këtë angazhim, por në realitet nuk kishte bërë asnjë hap konkret për të vijuar me punimet përkatëse, duke e vënë në rrezik serioz vijueshmërinë e këtij projekti madhor dhe jetik për zhvillimin e vendit tonë.

Risqe nuk ka, pasi ky koncesion do të pushojë së ekzistuari në vitin 2019, pra ndërtimi i rrugës, ku pritet që të kryhet pagesa e fundit, sipas ligjit për këtë qëllim.

Ndërtimi dhe Operimi i Rrugës së Arbrit, me kohëzgjatje 13 vjet, 2018 – 2030.

Kostoja buxhetore totale, e parashikuara: 33, 6 miliardë lekë. Kostoja buxhetore mesatare ndër vite është 2, 8 miliardë lekë.

Me anë të kësaj PPP-je, pra të këtij partneriteti publik privat, siç e theksova, Shqipëria dhe populli i Dibrës do të ketë rrugën për t’u lidhur me Tiranën, me Durrësin, me detin, me rajonin, gjithashtu edhe me Dibrën në anën tjetër të kufirit. Do të kishin pritur 25 vite dhe nuk do ta kishin atë rrugë, nëse nuk do të kishim bërë këtë projekt.

Ndërtimi, operimi dhe mirëmbajtja e rrugës Milot – Morinë, me kohëzgjatje 31 vjet. Kosto buxhetore totale e parashikuar: 12, 3 miliardë lekë. Kosto buxhetore mesatare vjetore 825 milionë lekë

Përfitimet. Nëpërmjet këtij koncesioni, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë zgjidh një problem të rëndësishëm për sa i përket mirëmbajtjes në tërësi të një aksi rrugor kombëtar. Njëkohësisht, partneri privat merr përsipër të ndërtojë dhe rindërtojë disa segmente të caktuara të rrugës, të cilat nuk ishin ndërtuar sipas standardeve, si për shembull Ura e Kukësit, me një vlerë totale rreth 43 milionë Euro. Përdoruesve të këtij aksi do t’u duhet të paguajnë një tarifë kalimi, e cila parashikohet në nivelin 5 euro, ndërsa qytetarët e qarkut do të paguajnë vetëm 1 mijë lekë të vjetra udhëtimi, pra 100 lekë.

Risku i këtij projekti është risku i kërkesës, i cili është i ndarë midis koncesionarit dhe autoritetit kontraktor.

Ministria e Financave. Koncesionin e Skanimit, skanerët e famshëm në Dogana, me kohëzgjatje 15 vjet, 2014-2029 e morëm dhuratë nga qeveria e dikurshme e Sali Berishës, nga këta që flasin për risqet e PPP-ve.

Kosto buxhetore: 27 miliardë lekë

Kosto buxhetore mesatare: 1, 9 miliardë lekë në 2019-ën, që do të paguhet nga qytetarët shqiptarë. 1, 9 miliardë për skanerin. Isha në disa vende të rajonit, ku skanerët ishin pronë e doganës dhe kushtonin shumë herë më pak.

Vazhdojmë me Ministrinë e Arsimit, Sportit dhe Rinisë.

Ndërtimi i shkollave të arsimit parauniversitar në bashkinë e Tiranës, me kohëzgjatje 8 vjet, 2017 – 2024.

Kosto buxhetore totale e parashikuar: 9, 8 miliardë lekë

Kosto buxhetore mesatare vjetore: 1, 4 miliardë lekë.

Nëpërmjet këtij partneriteti publik privat Ministria e Arsimit dhe bashkia Tiranë, si bashkëfinancues, synojnë t'i japin fund mbipopullimit kronik të klasave në çdo nivel të arsimit parauniversitar. Këta thonë: “Mos e bëni! Prisni 20 vjet. Mos e bëni! Le të dynden fëmijët në një klasë dhe të mos marrin shërbimin dhe rehatinë e merituar. Mos e bëni thonë!”.

Ne po e bëjmë. Synohet që kjo infrastrukturë të jetë gati për t'u vënë në funksionim të plotë brenda periudhës 2019 – 2020, duke respektuar të gjitha standardet bashkëkohore. Si shkolla “Kosova” do bëhen, që shkojnë të gjithë dhe e kanë si pelegrinazh tani, edhe këta që mungojnë.

Për katër kontratat koncesionare PPP në proces, me kosto buxhetore si vijon:

Ofrimi i shërbimeve laboratorike nga Ministria e Shëndetësisë dhe e Mbrojtjes Sociale, me kohëzgjatje 2019-2028.

Kosto buxhetore 8, 86 miliardë lekë.

Kosto buxhetore mesatare vjetore 886 milionë lekë.

Këtu përfitimet janë shumë të mëdha, megjithatë është në *pipeline*. Unë nuk po ndaloj tek përfitimet.

Kemi Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë.

Për projektin e koncesionit/PPP “Për projektimin, ndërtimin, operimin dhe mirëmbajtjen e rrugës Thumanë-Fushë-Krujë-Vorë-Kashar, një nga akset kryesore që lidh Veriun me Jugun. Këta i thonë Veriut dhe Jugut: “prisni 25 vite, se nuk i dihet çfarë ndodh”, ndërkohë që ne, nëpërmjet këtij projekti do të bëjmë të mundur një nga akset më të rëndësishme të vendit.

Kostoja buxhetore totale e parashikuar është 56, 3 miliardë lekë. Kosto buxhetore mesatare ndër vite, në 13 vite, është 4, 3 miliardë lekë.

Ky është investim i menjëhershëm, duke futur në tregun vendas më shumë likuiditet, mundësi për vende të reja pune, e përmenda aksin.

Duke qene se zona e Fushë-Krujës është zonë industriale, me lehtësimin e trafikut shkurtohet koha e transportit, gjë që rrjedhimisht ndihmon në zhvillimin e biznesit brenda vendit, dhe siç e theksova në momentin 1, është pjesë e rëndësishme e asaj që kemi diskutuar, e autostradës Adriatiko-Joniane, apo siç e quajmë ndryshe: Blue Highway.

Në planin e qeverisë për zhvillim, një pjesë e ndjeshme është dhe zhvillimi social. Përveç të tjerave, ky propozim për ndërtimin e segmentit rrugor Thumanë-Vorë-Kashar do ketë një impakt shumë pozitiv dhe në zhvillimin social, e jo vetëm të zonës.

Po brenda Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë kemi projektin me objekt: “Përdhënie me koncesion/PPP, për ndërtimin e segmentit rrugor Milot-Balldren”, afati 13 vjet.

Kosto buxhetore totale e parashikuar: 5 miliardë lekë. Kosto buxhetore mesatare vjetore: 8 miliardë lekë.

Nuk po i them përfitimet, meqë janë pothuajse të njëjta me ato që përmenda më sipër.

Projekti tjetër, ai me objekt “Projektimi, ndërtimi, financimi, mirëmbajtja e segmentit rrugor Porti i Jahteve-Bypass Orikum-Dukat, sipas modelit Partneritet Publik Privat”, afati 13 vjet. Kosto buxhetore totale e parashikuar: 11, 7 miliardë lekë. Kosto buxhetore mesatare vjetore: 0, 9 miliardë lekë.

Përfitimet nuk kam nevojë t’i them, sepse ju i dini, të gjithë qytetarët i dinë.

Ndërkohë, dua të ndaj me ju disa ndryshime të rëndësishme, që parashikohen t’ju vijnë për shqyrtim në këtë komision, shpresoj brenda vitit, për ligjin nr. 125 “Për koncesionet dhe partneritetin publik privat”, i ndryshuar. Këto ndryshime janë iniciuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë, nga qeveria: heqjen e propozimeve të pakërkuara në një sërë sektorësh.

Në draftligjin që kemi propozuar, në konsultim edhe me partnerët ndërkombëtar, paraqesim kufizimin e të drejtës së identifikimit dhe zhvillimit të propozimeve të projekteve të koncesionit/PPP, nëpërmjet propozimeve të pakërkuara nga sektori privat. Konkretisht, me anë të këtij ligji është propozuar që, nga data 1 korrik 2019 të lejohen propozimet e pakërkuara vetëm për realizimin e punimeve dhe/ose ofrimin e shërbimeve në porte, aeroporte, si dhe për prodhimin dhe shpërndarjen e energjisë elektrike, energjisë për ngrohje, shpërndarjen e gazit natyror. Pra, transporti dhe infrastruktura nuk do të kenë më propozime të pakërkuara.

Gjithashtu, ky projektligj përcakton shprehimisht që, pas datës 1 korrik 2019, nuk do të jetë më e mundur të propozohen nga sektori privat projekte koncesioni/PPP, në formën e

propozimit të pakërkuar, për ndërtimin, operimin, mirëmbajtjen dhe rehabilitimin e rrugëve nacionale me rëndësi të veçantë. Pra, nuk do të ketë.

Heqja e bonusit për propozimet e pakërkua.

Pra, edhe ato që do të ngelen me propozime të pakërkua, siç e theksova më lart, që janë portet, aeroportet apo shërbimet, do të hiqet bonusi, pra, sistemi i shpërblimit të propozuesve të pakërkuar me pikë bonus. Për të nxitur sektorin privat për të propozuar projekte të studiuara duke përdorur kapacitetet dhe eksperiencën e tyre, është propozuar zëvendësimi i sistemit me pikë bonus, me atë të kompensimit në vlerë monetare të propozuesit të pakërkuar, në rast se ky i fundit nuk shpallet fitues. Në çdo rast, kemi thënë në draft ligj, vlera e kompensimit nuk mund të jetë kurrë më e lartë se 1% e vlerës së investimit. Pra, të mos lejojmë që të pakërkuarit të lozin me vlerën e projektit.

Forcimi i rolit të ministrisë përgjegjëse për financat.

Një tjetër qëllim i këtij projektakti është edhe përcaktimi më i qartë i rolit dhe përgjegjësi të ministrisë përgjegjëse për financat, në lidhje me vlerësimin, miratimin e projekteve të koncesionit/partneritetit publik privat dhe ecurinë e kontratave të koncesionit/PPP nga pikëpamja e implikimeve fiskale, individuale apo në grup për shërbimet buxhetore, deficitin buxhetor, qëndrueshmërinë e borxhit publik dhe detyrimet kontingjente eventuale.

Një parashikim tjetër është që, përpara nënshkrimit të kontratës përfundimtare të koncesionit/PPP, kjo kontratë të paraqitet sërish për vlerësim pranë ministrisë përgjegjëse për financat, me qëllim verifikimin, nëse autoritetet kontraktuese pas negocimit të saj, i janë përmbajtur vlerësimeve dhe rekomandimeve të dhëna nga ministria përgjegjëse për financat. Pra, dy herë: japim mendim për herë të parë, për sa i përket pjesës së shëndetshmërisë së financave publike, dhe pastaj i verifikojmë nëse ato vlerësime janë marrë parasysh apo jo.

Krijimi dhe funksionimi i Komitetit të Përzgjedhjes së Projekteve të Koncesionit/PPP.

Komiteti i Përzgjedhjes së Projekteve të Koncesionit/PPP do të jetë një organ kolegjal, me objekt kryesor të veprimtarisë përzgjedhjen e projekteve të Koncesionit/PPP, të cilët do të asistohen me ekspertizë të specializuar për hartimin e studimeve fizibilitetit; parashikimin e dispozitave të zëvendësimit të koncesionarit me propozim të institucioneve financiare. Për shkak se na ka rastisur rëndom në praktikë, që zëvendësohen koncesionarët me kërkesë të institucioneve financiare, pra transferim përgjegjësish, ne e kemi parashikuar në ligj edhe atë mundësi.

Ndërkohë përpara se ta mbyll, kjo është për qytetarët, për opozitën që mungon dhe për ne të maxhorancës. Ju kam sjellë disa PPP të tregut europian. Këto ditë bëme një kërkim vetëm për ta ndarë më ju. Janë 204 miliardë euro vetëm në transport në Europë dhe me ambient, arsim, siguri, rend publik, kulturë, shërbime publike, mbrojtje, shëndetësi, akomodim, shërbime komunitare, telekomunikacion dhe të tjera, janë 370 miliardë euro të bëra në tregun europian ESA 95 ose ESA 2010, që janë me pagesa disponueshmërie, që natyrshëm, për shkak të standardit, janë pjesë e numëruar e stokut të borxhit, por janë kontabilizuar si detyrime koherente vit pas viti.

Po ju sjell disa shembuj, vetëm për vitin 2016 janë 6 transaksione të mëdha që u financuan me PPP-të.

Faza II e trajnimit të fluturimeve ushtarake – paketa e «Fix Wings» 1,45 miliardë euro në Mbretërinë e Bashkuar. PPP, partneritet publik privat në Mbretërinë e Bashkuar.

Autostrada D4 / R7 në Sllovaki, 998 milionë euro.

Rrjeti broadband Nord-Pas-de-Calais, në Francë: 606 milionë euro.

Autostrada A6 Wiesloch-Rauenberg, në Gjermani: 600 milionë euro.

Autostrada A355, në Francë: 565 milionë euro.

Autostrada A 94 Pastetten-Heldenstein, në Gjermani: 500 milionë euro.

80% e transaksioneve të mbyllura janë PPP me pagesë nga qeveritë, kryesisht të bazuara në pagesat e disponueshmërisë, e njëjta gjë si ajo që bëjmë ne.

Ju kam sjellë dhe vitin 2017. Në vitin 2017, vlera e transaksioneve PPP, që arriti financimin në 14.4 miliardë euro, pra një rritje prej 22% me vitin 2016, po ju sjell vetëm 8 transaksione të mëdha. Janë:

Rrugë me toll Pedemontana Veneta, në Itali: 2.8 miliardë euro.

Autostrada Marmara Veriore, Sektori Kurtköy-Akyazý, në Turqi: 1.8 miliardë euro.

Kampusi shëndetësor Ikitelli i Stambollit, në Turqi: 1.1 miliard euro.

Rrjeti broadband i Grand Est në Francë: 1.1 miliard euro.

Autostrada Marmara Veriore, në Turqi: 1.1 miliardë euro.

Rolling stock West Midlands, hekurudhë në Britani: 896 milionë euro.

Kampusi shëndetësor i integruar i Izmirit, në Turqi: 717 milionë euro.

Kampusi shëndetësor i integruar i Gaziantep, në Turqi: 685 milionë euro.

Të gjitha, siç ju thashë, janë ose ESA 95 ose ESA 2010, standard ndërkombëtar kontabilizimi i koncensionëve dhe i partneritetit publik privat, ai standard që po e përdorim ne sot, që me të drejtë, në një vendim, Sali Berisha e ka vendosur si standard zyrtar, kur ka qenë Kryeministër dikur, në të shkuarën e largët.

Faleminderit!

Erion Braçe – Faleminderit, zoti Ministër!

Faleminderit edhe për ekspozenë e gjatë, natyrisht edhe të detajuar lidhur me këtë çështje që ka marrë një pjesë të madhe të diskutimit publik gjatë këtij viti. Mendoj se u bë mirë që të sqarohen disa gjëra deri në fund.

Kalojmë në pyetje.

Zonja Kushi.

Evis Kushi – Zoti Ministër, faleminderit për sqarimet që dhatë. Ju dëgjova me shumë vëmendje dhe më vjen pak keq se m'u duk sikur jeni bezdisur pak nga pyetjet, uroj të jem e gabuar, por kjo përshtypje m'u krijua nga mënyra si folët sot.

Erion Braçe – Ju lutem, zoti Ministër, të mbarojë zonja dhe pastaj mund të flisni.

Evis Kushi – Unë prandaj po them qofsha e gabuar.

Arben Ahmetaj – Ju nuk jeni asnjëherë gabim. Për mua është kënaqësi të sqaroj qytetarët dhe ju për një gjë.

Erion Braçe – Këtë mbledhje e drejtoj unë, zoti Ministër.

Tani fjalën e ka zonja Kushi.

Arben Ahmetaj – Ju lutem, është kënaqësi dhe jo bezdisje për mua.

Evis Kushi - Shumë mirë që nuk qenke bezdisur, sepse ne jemi këtu për të bërë ato pyetje që i mendojmë të arsyeshme, jemi këtu për të bërë pyetjet që mendojnë edhe qytetarët që ne përfaqësojmë, por përgjegjësia jonë është edhe më e madhe ngaqë nuk është opozita, me qëllim që të jemi të kujdesshëm dhe çfarë akuzash ata artikulojnë çdo ditë në media në debate ose portale ne t'i diskutojmë këtu dhe t'i sqarojmë. Bëtë shumë mirë sot që sqaruat mënyrën si kontabilizohen, për shembull, të gjitha kontratat koncesionare ose të partneritetit publik privat.

Në lidhje me çështjen për të cilën jemi mbledhur, mua më vjen mirë dhe e vlerësoj shumë faktin që për të dytin vit radhazi, pas praktikës së vitit të kaluar, ju vini me një listë të detajuar të kontratave koncesionare të përfshira në buxhet, sepse kjo ka vlerë edhe për transparencën, edhe për informim, sepse në vitet e kaluara ishim mësuar të mos kishim asgjë përpara dhe të diskutonim në tym lidhur me këtë çështje. Gjithashtu, e vlerësoj shumë pozitivisht edhe faktin se disa nga sugjerimet e Fondit Monetar Ndërkombëtar, por edhe të Bankës së Shqipërisë, sepse dje Guvernatori i Bankës së Shqipërisë dha disa sugjerime për kontratat koncesionare, janë reflektuar, e kam fjalën këtu, për shembull, për faktin që kontratat koncesionare duhet të reflektojnë prioritetet strategjike. Mua më rezulton se pjesa më e madhe e tyre vërtet janë të sektorëve strategjikë dhe reflektojnë këtë sugjerim.

Sugjerimi i dytë lidhet me kontabilizimin që sapo u sqarua, mënyra si kontabilizohen sipas standardeve ndërkombëtare dhe janë të përfshira në ligj.

Tani, nuk e di nëse keni statistika ose informacion të hollësishëm në lidhje me të gjitha kontratat koncesionare ose të partneritetit publik privat, si po ecin, sa i kanë respektuar afatet dhe kushtet e përfshira në kontratë? Këtu nuk e kam fjalën vetëm për kontratat që janë lidhur në katër vjetët e kaluar, por edhe për kontratat që i takojnë viteve të mëparshme. Pra, si po ecin, sa i kanë respektuar afatet?

Pyetja e dytë: një tjetër rekomandim që është lënë në vazhdimësi nga Fondi Monetar Ndërkombëtar ka të bëjë me menaxhimin e risqeve të këtyre kontratave. Ju për çdo kontratë dhatë risqet, unë desha të di çfarë masash ka marrë qeveria apo çfarë masash do të marrë pikërisht për të menaxhuar risqet fiskale që shoqërojnë këto kontrata koncesionare?

Së fundi, duke u nisur nga sugjerimi që bëri dje Guvernatori, sa i takon përmirësimit të kapaciteteve profesionale të njësive që merren me kontraktimin, me vlerësimin, me administrimin dhe me monitorimin e projekteve, sidomos ato që janë ligjore dhe financiare, pra është një çështje që kërkon më shumë vëmendje, jo se nuk e ka pasur deri tani, ka pasur, por besoj se ende më shumë vëmendje duhet në këtë drejtim.

Meqenëse e përmendët dy-tri herë që jam votuar masivisht në zonën time në Elbasan, do ta uroja këtë gjë edhe për ju që në zgjedhjet e ardhshme të votoheni edhe ju masivisht në zonën tuaj.

Erion Braçe- Zonjë, e vendosin njerëzit këtë punë, nuk e vendosini ju kush merr më shumë vota.

Arben Ahmetaj – Edhe unë masivisht bashkë me anëtarët e tjerë të PS-së jam votuar. 5300 vota morëm në Rrogozhinë dhe 1000 vota në Kavajë.

Një sqarim që na vlen, unë ju kam sjellë vendimin nr. 575, sepse do të duhet të flasim me fakte me njëri-tjetrin, kur përmendim një precedent, siç është standardi i ESA 95. Këtë e lexoj më shumë për qytetarët se për ne këtu, që tashmë jemi shumë të njohur. Ky është vendimi nr. 575 i korrikut 2013. Kryeministër ka qenë Sali Berisha. Vendim i flet për miratimin e rregullave, vlerësimin dhe dhënien me koncesion partneritet publik privat. Pra, jemi duke folur për një vendim që ne si maxhorancë e gjetëm të kaluar dhe, për hir të së vërtetës, shumë mirë që ishte kaluar.

Tani, në pikën 6 të nenit 8 thuhet: Alokimi i riskut do të përdoret, gjithashtu, si një mjet themelor për të cilësuar nëse koncesioni ose PPP-ja është klasifikuar si brenda ose jashtë bilancit të qeverisë në bazë të rregullave të sistemit europian, të llogarive ESA 95,

sipas mënyrës së kombinimit të alokimit të tri llojeve të mëposhtme të risqeve: të disponueshmërisë, i ndërtimit, dhe i kërkesës”.

Pra, ky është një diskutim që ta kuptojnë qytetarët që kur të flasim për PPP-të ne kemi gjetur brenda formatit makroekonomik të uljes së borxhit instrumente për t’iu shërbyer qytetarëve të Dibrës, Korçës Shkodrës dhe këtu vlerësohet qeveria dhe maxhoranca.

Sa i përket monitorimit, sipas ndryshimeve që i kemi bërë ligjit nr. 125, autoritetet kontraktore janë të detyruara që përpara nënshkrimit të kontratës së koncesionit me ofruesin ekonomik të shpallur fitues, ta paraqesin atë për vlerësim. Pra, është momenti që ju iu referuat për të rritur filtrin. Kjo nuk është një kërkesë e Bankës së Shqipërisë, as rekomandim, ky është një diskutim që ne e kemi pasur me Fondin Monetar prej disa kohësh prandaj ka një proces brenda qeverisë për forcimin e fuqive monitoruese dhe të njësive monitoruese fiskale brenda Ministrisë së Financave.

Ndërkohë në pikat 4,5,6 të nenit 3, ku flitet për monitorimin, autoritetet kontraktuese i paraqesin sa herë që kërkohet, por jo më pak se tri herë në vit, ministrit përgjegjës për Financat raportet e përmbledhura të monitorimit të zbatimit të kontratave të koncesionit me argumentet dhe shpjegimet përkatëse. Forma përmbajtja dhe afatet e raportimit përcaktohen me udhëzim të ministrit të Financave. Bazuar në raportet e monitorimit, të specifikuar në pikën 4 të këtij neni, Ministria përgjegjëse për Financat mund t’u rekomandojë autoriteteve kontraktuese marrjen e masave për përmirësimin e performacës në ofrimin e shërbimeve dhe punëve publike, objekt i këtyre kontratave, si dhe për minimizimin ose eliminimin e risqeve të drejtpërdrejta dhe të tërthorta, që ndikojnë në buxhetin e shtetit. Në pikën 6 të nenit 3 thuhet: “Autoritetet kontraktuese brenda 6-mujorit të parë të çdo viti dërgojnë në Ministrinë përgjegjëse për Financat pasqyrat financiare vjetore të audituara dhe të konfirmuara nga autoritetet tatimore”. Pra, ka një procedurë të plotë dhe ne presim informacionin e fundit në fundviti nga ministritë përgjegjëse.

Me të na ardhur në fund të vitit informacioni i 6 – mujorit, do t’jua vëmë në dispozicion. Sigurisht që ka kontrata të cilat kanë avancuar sidomos këto të kompanive të ndërtimit kanë avancuar, shumë mirë. Ka kontrata që kanë risqet e tyre për shkak të risqve të kërkesës, këto i kemi të detajuara duke iu referuar 6-mujorit të kaluar, por patjetër që kemi edhe informacione të detajuara për kontrata specifike, të cilat duhen monitoruar në vazhdimësi për shkak të riskut fiskal që transpozojnë në buxhet. Do t’jua sjellim në fund të këtij viti kur të gjitha ministritë dhe autoritetet kontraktore do të bëjnë informacionin përfundimtar.

Erion Braçe -Faleminderit!

Zonja Kushi.

Evis Kushi – Së fundi, e vlerësoj shumë pozitiv iniciativën tuaj të fundit për heqjen e propozimeve të pakërkua nga disa sektorë. Besoj se në seancë do ta diskutojmë më në detaje.

Erion Braçe- Zoti Ministër, kam unë disa pyetje. Po e nis së pari, me detyrimin që kemi tërë jetën nga ligji për buxhetin e shtetit dhe që ka të bëjë me tavanin e shpenzimeve për partneritetin publik privat, në raport me të ardhurat tatimore faktike të një viti më parë. Ju falënderoj për tabelat që keni sjellë, informacionin respektiv dhe skenarin që ju keni ndërtuar me këtë çështje që buron nga ligji. Unë do të doja t'ju pyesja drejtpërdrejtë: shoh nga tabelat e viteve 2017-2028 që të ardhurat tatimore do të dyfishohen, pra nga 400 miliardë në vitin 2017 në 806,9 miliardë në vitin 2028. A mund të më thoni cili do të jetë burimi që do të ushqejë të ardhurat tatimore që praktikisht sipas skenarit tuaj dyfishohen në vitin 2028, sepse në raport me to bëhen edhe llogaritjet e tavanëve të shpenzimeve buxhetore në raport me partneritetin publik privat?

Arben Ahmetaj – Në parashikimin e të ardhurave kemi bërë parashikimin e standard të rritjes së të ardhurave nga viti në vit duke iu referuar një rritjeje nominale nga 5-6% dhe shkojmë në ato shifra që ju i referoheni. Ne kemi ndjekur variantin shumë konservator dhe arsyeja pse ndjekim variantin konservator është se duam që ta mbajmë nën 5%, përtej 4,5, më të ulët se 4,5 në vazhdimësi tavanin që të mos e rriskojmë asnjëherë me ndonjë shok të mundshëm makroekonomik. Pra, mbetet i pariskuar gjatë të gjithë periudhës. Kemi përdorur formula standard që ne i kemi ndarë edhe gjatë të ardhurave për parashikimin e tyre. Sigurisht që nuk kemi asnjë rritje taksash të planifikuar.

Erion Braçe- Po, pra, kjo më bëri përshtypje, për sa kohë që nuk ka rritje taksash.

Arben Ahmetaj- Po, nuk ka rritje taksash, siç e ka diskutuar edhe kryeministri, do të ketë një moratorium.

Erion Braçe - E kuptoj dhe për këtë arsye ju pyeta se cili do të jetë burimi i këtyre të ardhurave që dyfishohen në vitin 2028?

Arben Ahmetaj – Po ta rishikoni përllogaritjen është varianti konservator 5-6% nominal që ne kemi na çojnë **kompaund** në vitin 2028 në dyfishim të të ardhurave.

Erion Braçe- Dakord, por ka diçka që nuk shkon.

Arben Ahmetaj – Atje ka një bazë normale të rritjes së GDP-së.

Erion Braçe- Nga viti 2007 në vitin 2014 rritja është 24 miliardë, nga viti 2018 në vitin 2019 është po prapë aq, shkon diku te 26-27 miliardë, ndërkohë që po të shikojmë ritmin nga viti 2026 në vitin 2027, 2028 rritja shkon me gati 40.

Arben Ahmetaj– Po, se baza është rritur, por përqindja ka mbetur e njëjtë. Pra, nominalisht gjithmonë do të vijmë duke u rritur, sepse zgjerohet baza ekonomike, se nuk rrimë me të njëjtin kuadrat baze tatimore, por po ta shikoni në përqindje nominale nga viti në vit ruan rritjen normale të 5,5%-6% .

Erion Braçe- Ju jeni i bindur për këtë skenar?

Arben Ahmetaj - Unë jam shumë i bindur, madje po jua them edhe me përgjegjësi që jemi duke ndjekur aty një projekt konservator të rritjes ekonomike, pra nuk është se kemi krijuar në e mendjen tonë një shpërthim ekonomik të çuditshëm, por kemi parashikuar një rritje normale.

Erion Braçe - Po në vijim të pyetjes që bëra më sipër, me sa duket kulmi i pagesave në raport me PPP-të, do të jenë vitet 2022, 2023, 2024, ku shkojnë 4,3%, 3,9%, 3,9 e pastaj kurba vjen në rënie. A mbulohet kjo me ritmin e rritjes së të ardhurave në vite?

Arben Ahmetaj- Gjithë ngarkesa do të jetë shumë e ulët, nga 5%, do të jetë 3,9, deri në 4,3 %, që do të thotë se kemi një amortizator, po e quaj për thjeshtësi ndaj qytetarëve, 0,7% të të ardhurave tatimore totale të vitit paraardhës në mënyrë që të mos e riskojmë asnjëherë tavanin e 5%-shit. Është bërë me shumë kujdes, dhe na çon te një merak tjetër që kemi pasur. Ka një arsye që pagesat vjetore shkojnë deri në vitin 2023-2024 duke u rritur, pastaj duke zbritur. Cila është arsyeja? Risku të kalojë nga privati që buxheti i shtetit të mos paguajë menjëherë mesataren e 13 vjetëve që në vitin e parë, por të fillojë të jetë shumë e ulët mesatarja në mënyrë që të paguajmë më pak ndërkohë që partneri privat ka ecur me investimin në rrugë. Pra, janë të parashikuara duke futur, së pari, konservatoren dhe, së dyti, duke mbajtur një amortizim prej 0,7% në maksimum. Në muajt e tjerë janë edhe më të mëdha amortizimet, që të mos e kapim kurrë 5% -shin.

Erion Braçe- A ka rreziqe që këto të ardhura të mos realizohen dhe detyrimi për të ruajtur tavanet buxhetore të prekë shpenzimet? Në rast se do të prekin shpenzimet, cilët sektorë do të prekin shpenzimet?

Arben Ahmetaj – Siç ju thashë, ne vazhdojmë vetëm me variantin konservator.

Erion Braçe- Pra, ju jeni i bindur që këto të ardhura realizohen? Po ju pyes për herë të dytë.

Arben Ahmetaj – Jam shumë i bindur. Risku gjithmonë është nga shoku makroekonomik, por ne kemi marrë minimumin, pra nuk kemi ecur me një variant normal, kemi marrë një variant konservator të rritjes ekonomike. Pra, kemi absorbuar edhe inflacionin e ulët, edhe shokun, le të themi, goditjen që mund t'i japë në përqindje rritjes sonë, partnerët tregtarë, Italia, Greqia dhe Europa, pasi e kemi shumë të ngushtë korelimin, sidomos me

Italinë dhe Greqinë, me ecurinë e tyre ekonomike, kështu që unë jam i bindur se aty kemi amortizim dhe kemi risqe minimale...

Erion Braçe – Nuk do t'i impaktojnë shpenzimet?

Arben Ahmetaj – Po.

Erion Braçe – Faleminderit për përgjigjet që na dhatë për këtë grup pyetjesh!

Do të doja dija, pasi ju iu referuat 11 kontratave dhe më pas shtuat edhe 4 të tjera të partneritetit publik-privat, apo jo, 11 janë efektive dhe 4 të tjerat janë në proces. Në harkun e këtyre viteve që është ndërtuar edhe skenari, edhe nën dritën e ndryshimeve të reja, që ju do të avanconi në ligjin për partneritetin publik-privat dhe për koncesionin, doja të dija nëse ka kontrata të tjera që janë përfshirë në këtë skenar apo kontratat e reja do të shtohen mbi këtë skenar?

(Diskutime pa mikrofon)

Për ta kuptuar, janë këto 11 plus 4 apo ka edhe të tjera që janë përfshirë në këtë skenar apo janë jashtë këtij skenari?

Arben Ahmetaj – Nuk ka kontrata të tjera që do të marrin mbështetje buxhetore.

Erion Braçe – Nuk ka kontrata të tjera.

Zoti Ministër, ju pyes, sepse kam dëgjuar për interesin nga Kashari në drejtim të Rrogozhinës; kam dëgjuar për interesin tjetër për tunelin në Llogara; kam dëgjuar për aeroportin e Kukësit; kam dëgjuar për aeroportin e Vlorës. Këto do të jenë apo nuk do të jenë dhe në qoftë se do të jenë a janë përfshirë në skenar, apo jo?

Arben Ahmetaj – Pyetja juaj është shumë e qartë. Asnjë nga këto që thashë më lart nuk do të ketë mbështetje buxhetore...

Erion Braçe – Ato që thashë unë?

Arben Ahmetaj – Po, ato që thatë ju.

Pra, qoftë Tiranë-Durrës me tri linja, qoftë në 2026-ën një variant potencial Kashar-Rrogozhinë, pasi ka kombinime të ndryshme të propozimeve që janë larg të qenit të detajuar legalisht, apo aeroporti i Kukësit të cilit ju referuat, apo aeroporti i Vlorës, këto praktikisht nuk kanë mbështetje buxhetore...

Erion Braçe – A është e drejtë kjo? Në dijeninë time segmenti nga Thuamana në Rrogozhinë ka qenë i plotë. Gjysma do të marrë mbështetje buxhetore dhe gjysma tjetër do të paguhet me biletë?

Arben Ahmetaj – I gjithë sistemi i rrugëve në një të ardhme, gjë të cilën nuk e vendos unë, por e vendos maxhoranca sot dhe po e njëjta maxhorancë po nesër, rrugët për t'u

mirëmbajtur do të bëhet me toll, por edhe për të futur instrumentin e pagesës ndaj koncesionarit...

Erion Braçe – Përtej këtyre viteve që janë në kontratë, apo jo? Siç e thatë edhe ju, kontratat janë realizuar që për 13 vjet ai jo vetëm do ta ndërtojë rrugën, por edhe do ta mirëmbajë atë. Pra, përtej këtyre 13 vjetëve do të vendoset...

Arben Ahmetaj – Përtej këtyre 13 vjetëve...

Erion Braçe – Unë për këtë ju fola...

Arben Ahmetaj – Jo, ka edhe diçka tjetër...

Erion Braçe – Prandaj ju thashë, sepse më duket e padrejtë për këtë pjesën tjetër...

Arben Ahmetaj – Zoti kryetar, modeli është dinamik dhe evoluon. Për shembull, një rrugë që është ndërtuar me mbështetje nga buxheti do të vendosej toll, po të vendosej toll, atëherë do të ulej masa që paguan buxheti i shtetit për të njëjtën shumë dhe kjo është automatike. Po ju marr një shembull konkret, sepse për qytetarët kështu do të ndodhë vërtetë, por unë po e marr thjesht si shembull. Rruga Thumanë-Kashar ndërtohet me logjikën e mbështetjes buxhetore në 13 vjet. Në vitin iks, të pestë, të gjashtë apo të shtatë maxhoranca vendos të vërë toll. E gjithë shuma e pagesave që do të vijë nga tolli do të ulë pagesën vjetore të buxhetit të shtetit automatikisht, sepse është pjesë e modelit. Pra, kur vendosim tollin në model...

Erion Braçe – Në qoftë se ju e keni këtë në kontratë jam dakord, por në qoftë se nuk e keni...

Arben Ahmetaj – Siç edhe jua thashë, janë dinamike dhe mund të negociohen në të ardhmen. Pra, qeveria vendos të vendosë toll dhe për këtë logjikën e ka, qoftë atë financiare, qoftë për mirëmbajtje apo me 100 mënyra të tjera.

Meqë ju përmendët disa nga projektet, për shembull propozimi që është fillestar, Tiranë-Durrës për ta zgjeruar me 3 linja, është pa mbështetje buxhetore, zero lekë nga buxheti i shtetit. E njëjta gjë...

Erion Braçe – Si me tri linja? Do të shtohet një linjë e re apo...

Arben Ahmetaj – E kisha fjalën për korsin.

Erion Braçe – Ajo rrugë do të ndërtohet nga e para?

Arben Ahmetaj – Po ju them që projekti fillestar presupozon zgjerimin e rrugës Tiranë-Durrës nga dy korsin që janë me 3,5 në tre korsin me 3,75-e të standardeve europiane. Unë jam ministër i Financave dhe jo ministër i Infrastrukturës dhe nuk do të doja të hyja te standardet, por po ju them vetëm një fakt. Sot korsitë janë 3,5, ndërsa nesër do të jenë me 3,75 dhe për to nuk do të paguhet asnjë lekë nga buxheti i shtetit...

Erion Braçe – E kuptoj këtë pjesë, prandaj ju pyeta...

Arben Ahmetaj – Brenda të njëjtit propozim është në një fazë të dytë rruga Kashar-Rrogozhinë të varësi të ecjes së modelit financiar, por pa asnjë kontribut nga buxheti i shtetit.

Erion Braçe – Në rregull. Kalojmë në një grup tjetër pyetjesh.

Zoti Ministër, po u referohem koncesioneve në fushën e shëndetësisë. Doja të di se në çfarë niveli është zbatimi i kontratave të tyre veçanërisht për pjesën e investimeve që ka detyrim partneri privat për t'i realizuar në të tria këto fusha që janë përcaktuar dhe për të cilat është kontraktuar me partneritetin publik-privat.

Që të tria këto janë ndërtim-operim dhe pastaj transferim pas 10 vjetësh, apo jo? Unë jam i interesuar pikërisht për pjesën që ne do të marrim në dorëzim pas 10 vjetësh, pra masa e investimit e trupëzuar deri tani?

Arben Ahmetaj – Të tria kontratat janë funksionale dhe e kanë përfunduar investimin e domosdoshëm për të qenë funksionale dhe sigurisht gjatë viteve në vazhdim do të bëhet mirëmbajtja e pajisjeve të sistemeve, të cilat siç e thatë edhe ju në fund të periudhës i kalojnë ministrisë si pronësi. Unë ju thashë që ndër vite janë gati 1,2, pa hyrë te rrugët...

Erion Braçe – Unë po ju pyes vetëm për këto të tria, zoti Ministër...

Arben Ahmetaj - ...1,2 miliardë, ndërkohë që këta e kanë bërë pothuajse plotësisht investimin që kërkohet për mirëfunksionimin e tyre.

Erion Braçe – Një pyetje tjetër. Ju iu referuat koncesioneve në fushën e mjedisit, incineratorit të Elbasanit, incineratorit të Fierit, të Tiranës, që kanë një kosto vjetore 662 milionë i pari, 753 milionë i dyti dhe 800 milionë i treti, për një periudhë të pacaktuar. A mund të më thoni për çfarë paguhet këto para? Jam shumë kurioz ta di, pasi edhe interesi lidhur me pagesat që kryen shteti për këto koncesione është shumë i madh.

Arben Ahmetaj – Në rastin e Elbasanit, besoj se nuk është e nevojshme ti kthehem fushës kancerogjene të mbetjeve...

Erion Braçe – Kjo është e qartë dhe ne e kemi pranuar këtë fakt.

Arben Ahmetaj – E para, përfitimi është që kemi shpëtuar qytetin dhe jo vetëm. Praktikisht, është një investim publik në formën e PPP-së që paguhet ndër vite...

Erion Braçe – Pra, ne shlyejmë vlerën e investimit të privatit...

Arben Ahmetaj – Po. Në fund, në mos gaboju në 2021 është Elbasani e merr në pronësi Bashkia e Elbasanit...

Erion Braçe – Pra, ne paguajmë vlerën e investimit?

Arben Ahmetaj – E saktë.

Erion Braçe – Po te ai i Tiranës?

Arben Ahmetaj – Në Elbasan dhe në Fier paguajmë vlerën e investimit, ndërsa tek i Tiranës ne i paguajmë subvencion Bashkisë së Tiranës për të paguar kosto për përpunimin në tonë të plehrave. Investimin e bën privati, nuk e paguan buxheti i shtetit. Praktikisht, kjo është një mënyrë tjetër partneriteti, njëra kur investohet dhe shteti paguan ndër vite me pagesë vjetore dhe tjetra, tjetra është logjika që ka përdorur Tirana, Bashkia e Tiranës dhe jo vetëm kjo bashki, sepse praktikisht mbështetja buxhetore bëhet nëpërmjet Bashkisë së Tiranës për gjithë qarkun dhe për ata që depozitojnë mbetje në Tiranë, praktikisht paguan shumë për tonë, nuk paguan investimin, sepse ai është i privatit.

Erion Braçe – Po për Elbasanin dhe për Fierin a do paguhet kjo tarifë?

Arben Ahmetaj – Jo.

Erion Braçe – Pra, njësitë vendore që do të dorëzojnë mbetje në Elbasan apo në Fier nuk do të paguajnë gjë?

Arben Ahmetaj – Jo, sepse do të shohin edhe asetin dhe aset i është i shtetit aty...

Erion Braçe – Nuk jam duke folur për Bashkinë e Fierit, sepse kjo bashki është model, por, fjala bie, mund të thotë që Bashkia e Divjakës do të paguajë kaq për ton? A ka të lejueshme këtë gjë, apo jo?

Arben Ahmetaj – Në qoftë se bashkia do të përdorë të njëjtën fushë?

Erion Braçe – Jo, do të përdorë të njëjtin incinerator.

Arben Ahmetaj – Do të hyjë në marrëdhënie kontraktuale me Bashkinë e Fierit.

Erion Braçe – Do të paguajë...

Arben Ahmetaj – Nuk e di, kjo varet nga Bashkia e Fierit dhe ajo e Divjakës.

Zoti kryetar, ka edhe një element tjetër...

Erion Braçe – Zoti Ministër, unë mendoj që për ndërtimin incineratorëve në Elbasan dhe në Fier paguajnë të gjithë, edhe ata të Lushnjës, të Divjakës, të Beratit, të Skraparit, të Shkodrës fjala bie, sepse paguhet nga taksimi i përgjithshëm. Kjo historia për vendosjen e tarifave mbi këtë pagesë sikur nuk shkon për sa kohë që paguhet nga buxheti i shtetit, apo jo?

Arben Ahmetaj – Unë prandaj e diferencova pronësinë. Çfarë dua të them me këtë? Me këtë dua të them që në finale, në 2021 apo në 2024 në Fier, aset i kalon pronë bashkive. Pra, buxheti i shtetit ka paguar dhe po lë një pronë që është incineratori. Incineratori ka kapacitet, sepse ka iks përpunim. E zëmë se ai ka 500 apo 600 mbetje dhe nëse aty shkojnë 1000 mbetje ai nuk i përpunon dot të gjitha, sepse do të ruajë nivelin e mbetjeve që ka parashikuar dhe do të përpunojë incineratori dhe ata do të hyjnë ose jo në marrëdhënie kontraktuale me njëra-tjetrën. Sa i takon modelit në Tiranë, ku incineratori ndërtohet nga

privati dhe do të jetë pronë e privatëve, është një model komplet tjetër. Sigurisht, bashkitë do të detyrohen të paguajnë për përpunimin e mbetjeve dhe kjo nuk është një metodologji apo model jo i njohur, pasi është i njohur gjithandej.

Erion Braçe – Kam përshtypjen se nuk do të funksionojë për qëllimin final, për pastrimin e territorit.

Arben Ahmetaj – Ai i Tiranës?

Erion Braçe – Jo, i Tiranë, por këta dy incineratorët e tjerë.

Arben Ahmetaj – Këta dy incineratorë po funksionojnë dhe po i pastrojnë territoret, të paktën ai i Elbasanit dhe kjo gjë është e sigurt.

Erion Braçe - Dakord, ai i Elbasanit është i sigurt, por unë shoh gjithandej, më lejoni ta bëj veten edhe deputet të asaj zone, plehrat që sjell Shkumbini poshtë në Divjakë...

Arben Ahmetaj – Ajo është histori tjetër, sepse ka të bëjë me punën që bëjnë bashkitë...

Erion Braçe – Kjo do të thotë që një pjesë e madhe e mbetjeve nuk po shkojnë në Elbasan...

Arben Ahmetaj – T'i dërgojnë, kjo është puna e tyre, të hyjnë në marrëdhënie me bashkitë...

Erion Braçe – Shqetësimi ynë në momentin që kemi marrë këtë iniciativë të operimit të kontratave me partneritetin publik-privat është që të kenë efektin maksimal si në fushën e shëndetësisë, në fushën e mjedisit, në arsim apo edhe në infrastrukturën më tutje. Prandaj, zonja Kushi, insistoi në njërën prej pyetjeve të saj për këtë pikë, prandaj edhe unë insistova për realizimin e këtyre kontratave, sepse në fund fare duam të matim impaktin e këtyre kontratave për ata sektorë ku ne kemi ndërhyrë.

Arben Ahmetaj – E drejtë. Po ju marr një shembull kontrate, meqë iu referuat Elbasanit. Kontrata, ka prerogativat e saj që i referohen shumës së investimit, teknologjisë ose shlyerjes dhe tonë mbetje përpunim në muaj. Ata tonë mbetje përpunim në muaj janë pjesë e parashikuar edhe në teknologji. E zëmë se janë 500, 600, 700 apo 1000 dhe deri në këtë gamë është e lehtë të depozitohen dhe të përpunohen, por kur kapaciteti kalon mbi 1000 i bie që është e nevojshme të depozitohen diku tjetër, të bëhet një instrument apo një agregat tjetër. Gjithsesi, ekzekutivi së bashku me legjislativin mendon afatmesëm dhe afatgjatë dhe për Elbasanin, Fierin apo Tiranën kanë menduar kapacitetin për vitet që do të vijnë. Ka një formulë shumë standarde, e cila ka të bëjë me numrin e popullsisë, me zhvillimin, me kilogram për mbetje për familje e të tjera, të cilat të çojnë në një parashikim afatmesëm. Ju iu

referuat një diçkaje specifike, mbeturinave në Shkumbin. Mbeturinat në Shkumbin janë përgjegjësi e bashkive...

Erion Braçe – Edhe në Seman...

Arben Ahmetaj – Nuk e kisha për lumin, sepse kjo është përgjegjësi e bashkive që t'i marrin dhe t'i depozitojnë; përgjegjësi e pushtetit vendor që t'i marrin dhe t'i depozitojnë në vendin e depozitimeve, pasi diku ka incinerator e diku jo. A e keni parë se çfarë është bërë në Durrës? Durrësi është kthyer...

Erion Braçe – Vendi i depozitimeve duhet mbyllur, zoti Ministër. Pra, në qoftë se ne duam të jemi efektiv në këtë pikë, ku çdo gjë transportohet në drejtim të incineratorëve kapacitetet e të cilave në përqindje janë shumë më lart sesa sasia e mbetjeve ditore që krijohet e të tjera me radhë, prandaj duhet të merremi me këtë gjë.

Po vij te koncesionet ndërtuese të infrastrukturës. Është krijuar një shqetësim jo vetëm te opozita, por edhe te medie, për vlera të ndryshme të dhënash në harkun në harkun kohor të 2 apo 3 vjetëve për të njëjtat objekte. Natyrisht është diçka e mirë që këto objekte janë listuar në atë regjistrin që ju thoni, si dhe janë pjesë e relacioneve shpjeguese në buxhetin e shtetit, por kjo nevojë për transparencë apo kjo kërkesë e përmbushur për transparencë ka sjellë këtë gjë.

Së pari, në lista keni edhe objekte, të cilat, siç e thatë edhe ju, nuk do të kenë mbështetje buxhetore. E mira është që këto lista të pastrohen...

Arben Ahmetaj – Për çfarë e kishit fjalën?

Erion Braçe – E kisha fjalën për listat që i bashkëngjiten relacionit të buxhetit të shtetit. Për shembull...

Arben Ahmetaj – 46% i prodhimit të brendshëm?

Erion Braçe – Jo. E kisha fjalën për listat që parashikohen të marrin mbështetje buxhetore nga buxheti i shtetit. Në vite të ndryshme kanë qenë objekte të ndryshme dhe e mira është që këto lista të pastrohen dhe ne të kemi një listë të atyre kontratave të partneritetit publik-privat që marrin drejtpërdrejtë mbështetje buxhetore për të cilat më pas të bëjmë edhe llogaritë në raport me tavanin që kemi me 5%-in e të ardhurave të tjera tatimore e të tjera me radhë.

Arben Ahmetaj – Kisha një pyetje nëse mundem. A keni ndonjë specifikë që t'i referohem direkt?

Erion Braçe – Patjetër, zoti Ministër! Në kohë të ndryshme kanë qenë rrugë të ndryshme. Për shembull, segmenti i rrugës Kardhiq-Delvinë në buxhetin e shtetit për vitin

2018 ka qenë me një vlerë të përcaktuar, ndërkohë që tani është zero, sepse do të mbulohet nga buxheti i shtetit.

Arben Ahmetaj – Në listën që ju kemi sjellë nuk e kemi...

Erion Braçe – E keni pasur në 2018-ën? Kjo ka sjellë atë llogarinë pastaj që shkojmë në 2 miliardë e kusur e të tjera me radhë...

Arben Ahmetaj – E kuptova.

Erion Braçe – Ndërkohë, pyetja e drejtpërdrejtë është se për disa kontrata të partneritetit publik-privat ka diferenca të mëdha nga vlerat e dhëna në relacionin e projektbuxhetit të shtetit për vitin 2018-të me atë të vitit 2019-të dhe pastaj edhe në kontratat finale për ato që janë realizuar. A mund të di se cila është arsyeja që kemi këto diferenca të mëdha për disa kontrata?

Arben Ahmetaj – Diferenca nga cila për cilën?

Erion Braçe – Për shembull, aksi Thumanë-Vorë-Kashar në 2018-ën na është prezantuar me vlerë 34,3 miliardë; në 2019-ën...

Arben Ahmetaj – Cili ishte?

Erion Braçe – Aksi Thumanë-Kashar.

Arben Ahmetaj – Aksi Thumanë-Kashar nuk ka për 2018-ën...

Erion Braçe – Si nuk ka pagesë?

Arben Ahmetaj – Jo, nuk ka pagesë as në 2018-ën dhe as në 2019-ën...

Erion Braçe – Ju lutem, zoti Ministër, edhe një herë. Shqetësimi që ka lindur dhe që u ka dhënë argument kolegëve tanë të opozitës, si dhe medias në deklarime publike dhe jo vetëm, por edhe në kronika, emisione të tjera me radhë, ka të bëjë me atë që ju keni paraqitur në projektbuxhetin e shtetit për vitin 2018...

Arben Ahmetaj – E keni fjalën për koston totale?

Erion Braçe – Po, për koston totale të rrugëve, jo për pagesën. Në vitin 2018-të ka një vlerë dhe në 2019-ën në të njëjtin relacion ka një vlerë tjetër të shtuar. A mund ta dimë arsyen pse në këto kontrata është shtuar kjo vlerë?

Arben Ahmetaj – Ju me të drejtë iu referuat kostove totale të secilës nga...

(Diskutime pa mikrofon)

... sapo thatë thelbin. Diferenca nga dhjetori i 2017-ës me 2018-ën tani ka ndryshuar. Për shembull një rrugë specifike, konkretisht ajo Thumanë-Kashar është në nivel të avancuar të negociatës, ku edhe projekti ka kaluar në projekt të detajuar. Shuma nuk është më një parashikim siç ka qenë dikur, por është një shumë e përlllogaritur në bazë të standardeve që ka Ministria e Infrastrukturës, e cila në finale i dërgon zyrtarisht edhe në ARSH, për t'u

certifikuar si kosto konkrete nga komiteti. Pra, njëra është parashikim pa projekt të detajuar, ndërsa kjo që sjellim tani në buxhetin e shtetit është për shkak se ka një draftkontratë të negociuar mbi bazën e një projekti të detajuar. Kjo është diferenca.

Erion Braçe – Dakord, por më lejoni të bëj diferencën midis interesit të shprehur në një propozim të pa kërkuar nga një kompani me një iks vlerë dhe pas garës, ndryshimin e vlerës.

Kam përshtypjen që nuk është normale. Krahasimet çalojnë.

Arben Ahmetaj – Krahasimi që bëra unë?

Erion Braçe – Jo juaji, ky imi. Pra, krahasimet çalojnë, por referuar segmentit Rrëshen-Kalimash, në dy aspekte, në atë të parashikimit në momentin e parë prej 416 milionë dollarësh dhe koston përfundimtare 1,3 apo 1,4 miliardë dollarësh, natyrisht që më lind pyetja: do të biem në të tilla trende, apo jo?

Arben Ahmetaj – Shumë e saktë pyetja juaj!

Erion Braçe – Së dyti, në segmentin Rrëshen-Morinë u konsumuan dy standarde komplet të tjera të çmimeve dhe të kostove respektive. Njëri që ishte i tenderuar nga buxheti i shtetit, nga Kalimashi në drejtim të Morinës dhe tjetri nga Rrësheni deri në Kalimash, ku kostot lëviznin me herë, të verifikuara të tilla nga Kontrolli i Lartë i Shtetit, nga Prokuroria e Republikës së Shqipërisë, nga Gjykata nuk u bë e mundur për “dhimbje barku”. Që të mos ndodhin më të tilla gjëra, a mund të kemi një standard me të cilin të realizohet secila prej këtyre kontratave?

Sot kemi një rrugë, autostradë nga Fushë-Kruja sipër në Veri dhe, natyrisht, kostot e asaj rruge do të fillojnë të krahasohen për nevoja politike me kostot e këtyre kontratave.

Së dyti, kemi kompani që konkurrojnë për të ndërtuar rrugë me buxhetin e shtetit apo me para të kredive të buta që ka marrë qeveria e Republikës së Shqipërisë, kostot fituese të të cilave ndryshojnë me disa herë në raport me këto kontrata të partneritetit të publikut për të njëjtën kompani. Në harkun e një jave, di unë, për shembull, një kompani ka fituar një tender atje dhe në krahun tjetër paraqet edhe propozime të tilla. Mund ta unifikojmë ne standardin e ndërtimit të një rruge, pastaj të konkurrimit etj. me radhë? Kështu krijojmë problematika brenda ndërtimit të të njëjtit tip rruge.

Arben Ahmetaj – Do të doja t’ju bëja një sqarim për çështjen e parë që ngritët dhe një referencë tek e dyta, se ministri i Financave nuk vendos manualin e rrugëve. Do të vij ta sqaroj edhe atë çështje.

Kemi detyrimin, ligjin, që të vijmë të parashikojmë kontratat e mundshme koncesionare për të vënë nivelin në këtë komision dhe pastaj në Kuvend, në mënyrë që

qeveria të mos lejohet ta kalojë atë tavan. Thënë kjo, kur vijmë me parashikim, kur kontratat ende nuk janë të negociuara, natyrisht që shifra flaktuon 1,2,3,4,5 % nga shifra që do të negociohet nga autoriteti kontraktor. Tani, për shembull, kemi mundësi që për një kontratë të nisur para një viti, të jemi shumë më të saktë për shifrën që vendosim në relacion. Ky është një hap para drejt transparencës.

Ajo që thatë për sa i përket kostos për njësi, po vij tek elementi tjetër, në dijeninë time në ARSH dhe Ministrinë e Infrastrukturës ka një manual të kostove të rrugëve, që po në dijeninë time, megjithëse nuk është tagër dhe përgjegjësi e Ministrisë së Financave, observohen, konsiderohen, referohen dhe përdoren si standard edhe në PPP. Pra, është ai standard, nuk është se ka dy standarde.

Unë ju solla një shembull jo pa qëllim, edhe ju gjithashtu, rrugën Tiranë-Elbasan. Një diferencë të rëndësishme po ua jap tani: Tiranë – Elbasan nisi me 304 milionë dollarë dhe do të përfundojë me 440 milionë dollarë, do të shkojë 46,1 po u materializuan dhe klejmet...

Erion Braçe – Nuk duhet të rikthehemi përsëri te diferencat që kemi për disa akse!

Arben Ahmetaj – Te partneriteti publik privat risku i ka kaluar privatit. U vendos çmimi, nuk ka më 20% plus, 20% këtu e 40 % atje, ka marrë riskun e ndërtimit...

Erion Braçe – Risku edhe mund të jetë, edhe mund të mos jetë i realizuar në fund të kontratës, puna është që ne do të paguajmë.

Arben Ahmetaj – Ka harxhuar paratë e tij dhe, në qoftë se nuk e ka mbaruar rrugën, nuk merr paratë.

Erion Braçe – Ai mund ta ketë mbaruar rrugën pa asnjë lloj risku, zoti ministër, zero. Mund të mos ketë pasur asnjë nga problematikat që ka sot rruga Tiranë-Elbasan, i projektuar dhe nisur keq, i hapur keq etj. me radhë. Mund të mos vuaj asnjë nga këto risqe, ndërkohë që i ka të përfshira në kosto. Në fund të 13 vjetëve ne duhet të paguajmë.

Arben Ahmetaj – Pyetja do të ishte: a kanë dalë jashtë manualit? Në dijeninë time, jo. Ministria e Infrastrukturës dhe ARSH-ja kanë një manual të konsoliduar dhe ndjekin atë.

Erion Braçe – Faleminderit!

Pyetja e fundit që kam lidhet me koncesionet në fushën e energjisë, të cilat, edhe me ndryshimet ligjore, ju duhet t'i lini të hapura përsëri.

(Ndërrhyrje pa mikrofon)

Po, pra, keni lënë të hapur mundësinë për propozime të pakërkuara në këtë fushë. Do ta diskutojmë kur të vijë ligji, sepse unë mendoj se është tejkaluar çdo lloj caku. Edhe ku ka pasur rrëqe, ka pasur një propozim të pakërkuar, pavarësisht faktit nëse e ka dëmtuar

komunitetin apo jo. Domethënë, është dhënë leja. Edhe kur ka pasur bukuri pafund është dhënë një leje pa pyetur fare për zhvillimin e atij komuniteti, por ka shkuar drejtpërdrejt në përmbushje të interesit të atij privati që ka paraqitur propozimin.

Pra, për mua, edhe kjo hapje është e paargumentuar dhe e paprovuar. Natyrisht, Sali Berisha është doktor në këtë fushë, ka bërë edhe një libër për këtë pjesë etj. me radhë “Për koncesionet në fushën e energjisë”, por mirë është të fillojmë të gjykojmë mbi bazën e asaj që ka ndodhur në terriore të caktuara etj. Kur të vijmë te ligji për koncesionet, do të flasim edhe për këtë pjesë. Ajo për të cilën unë kam interes, është pyetja: dua të di sa i kushtojnë buxhetit të shtetit këto koncesione? Sa u kushtojnë kompanive publike në sektorin e energjisë elektrike? Këto do të doja të dija, se këtu një faqe është për koncesionet në shëndetësi, mjedis etj. me radhë. Janë dhjetëra faqe me koncesione pafund, propozim i pakërkuar pafund në sektorin e energjisë.

Arben Ahmetaj – Kryetar, unë mund t’ju jap numrin e kontratave në total, 218...

Erion Braçe – Praktikisht çdo rrëke dhe pastaj kemi thatësi të poshtë.

Arben Ahmetaj – Po, por shumica janë energji dhe në total rreth 35 kontrata janë që nga viti 2014 e mbrapa. Pra, 180 kontrata afërsisht janë të bëra para vitit 2013.

Besoj se e dini se vetëm në periudhën gusht-shtator janë bërë...

Erion Braçe – Mos t’i hyjmë kësaj, zoti Ministër!

Vazhdojmë me përgjigjen e pyetjes.

Arben Ahmetaj – Aman se vdiqa ta them! Janë 23 kontrata të bëra vetëm në shtator 2013 para se të iknim dhe i kam bërë ditën e shtunë.

Erion Braçe – Zoti Ministër, ju thashë të mos i hyjmë kësaj teme për një arsye, se kam unë një pyetje tani: sa prej tyre janë rinovuar?

Vazhdojmë me përgjigjen e pyetjes, ju lutem.

Arben Ahmetaj – Po ju them vetëm Devollin, kostoja buxhetore është 6,7 miliardë lekë dhe nuk po u kalkuloj këtu koston indirekte nëpërmjet blerjes së energjisë për një nga ato me 100 euro. Pra, në qoftë se në tregun ndërkombëtar, kryetar, mega shitet 48 deri në 55 euro, njëra nga ato e ka 100. Pra, ne ia blejmë me 100. Shumica e tyre e kanë me 6,6 cent. Po nxjerr vetëm një llogaritje të këtij viti: vetëm këtë vit, goditja nga kjo disbalancë çmimesh është 35 milionë euro OSHE-ja, sepse ajo e mban goditjen, dhe mos harroni që OSHE-ja na del në bilancin e buxhetit të shtetit.

Erion Braçe – Patjetër, ndaj po pyes. Jo vetëm në bilancin tuaj, zoti ministër, por edhe në çmimin me të cilin blejnë konsumatorët.

Arben Ahmetaj – Natyrshëm!

Vetëm nga këto goditja këtë vit është 35 milionë dhe është bërë qesharake, sepse keq kur jemi thatësirë e keq kur kemi shira, vetëm për shkak të kësaj disbalance.

Faleminderit!

Anastas Angjeli - Nëse e kuptova mirë, zoti Ministër, ju thatë inceneratori i Tiranës do të ndërtohet nga privati dhe ne vetëm subvencionojmë për kuotë të caktuar për sasinë e plehrave që Bashkia e Tiranës përpunon atje. A ka filluar ndërtimi i inceneratorit të Tiranës?

Arben Ahmetaj – Në dijeninë time, kam parë edhe Ministrinë e Turizmit dhe Ambientit ku së bashku me Kryeministrin e kemi vizituar fillimin e punimeve atje.

Anastas Angjeli - Por në veprimtari nuk ka hyrë?

Arben Ahmetaj – Depozitimi i mbetjeve ka filluar.

Anastas Angjeli - Përpunon plehra kjo e reja që po bëhet?

Arben Ahmetaj – Inceneratori? Ende jo. Po përpunohet fusha dhe ka filluar ndërtimi.

Anastas Angjeli - Në buxhet keni parashikuar për të shuma të caktuara për periudhën 2018-2019-2020. Subvencioni është për këtë incenerator.

Arben Ahmetaj – Po, dhe është për fushën e depozitimit, sepse është projekt i integruar.

Antoneta Dhima - Faleminderit, zoti kryetar!

Faleminderit, zoti Ministër, për prezantimin!

Gjatë fjalës suaj theksuat se ka një monitorim nga ana juaj për kontratat koncesionare apo ato të PPP-së, të cilat kërkojnë mbështetje nga buxheti i shtetit.

Pyetja ime është: ministritë të cilat janë përgjegjëse, në rastin konkret, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë bëjnë monitorim të këtyre kontratave dhe cilat janë rezultatet e deritanishme për to?

Faleminderit!

Arben Ahmetaj – Këtë pyetje e bëri në mos gaboj edhe zonja Kushi. Lexova ligjin nr.125, megjithatë po e ripërmend: “Është detyrë e autoriteteve kontraktuese që të monitorojnë kontratat”. Detyrat e tyre, vazhdojnë të na informojnë ne (Ministrinë e Financave) duke na përcjellë raportin për ecurinë dhe për risqet, por monitorimi në traditë është detyrë e autoriteteve kontraktore. Për shembull, Infrastruktura dhe Energjia bën infrastrukturën e energjisë dhe mbetjeve, Shëndetësia monitoron në detaje mbetjet, ajo që bëjmë ne nëpërmjet njësisë sonë të risqeve është që vëzhgojmë kontratat në aspektin e kostos buxhetore dhe në qoftë se shohim një risk për shkak të kërkesës, apo shkaqe të tjera që pagesa

vjetore mund të shkojë përtej limiteve buxhetore, ne i kërkojmë autoritetit të reformojë dhe të vendosë kap urgjent. Pra, ne i monitorojmë nga ana fiskale, ndërsa autoritetet kontraktore janë të detyruara me ligj t'i monitorojnë kontratë më kontratë.

Erion Braçe – Ka pyetje të tjera? Po, urdhëroni, zoti Beqiraj.

Ismet Beqiraj – Përshëndetje, zoti Ahmetaj!

Do të sugjeroja për të gjitha kontratat koncesionare me PPP-të të bëhet një edukim më shumë mediatik, jo vetëm kur dalin përfaqësuesit kryesorë të ministrive, por edhe specialistë të fushës, në mënyrë që ta dijë edhe publiku, që të mos bëhet politikë, ta dinë edhe njerëzit, se edhe ne si deputetë shumë gjëra sot po i dëgjojmë se cilat janë risitë, që të jemi më të hapur ndaj publikut dhe medias. Jo vetëm kaq, por do të sugjeroja që këto kontrata të jenë transparente në mënyrë që njerëzit të mos hamendësojnë. Ajo që është më e rëndësishme, duhet të bëhet një edukim profesional nga specialistë të fushës dhe jo ata që kanë kostum politik, të cilët le ta bëjnë punën e tyre, për këto investime dhe shërbime që merr qytetari, pasi nuk është e drejtë që të presë si qytetari dhe fermeri edhe 20 -30 vjet të tjera që të ketë një rrugë me standardet europiane. Nuk mund të presin studentët, nxënësit që të mbipopullohen auditorët dhe klasat pastaj të bëhen shkollat e ta gëzojnë ata që do të vijnë pas 20 apo 30 vjetësh kur sipas skenarëve të rritjeve buxhetore t'i kemi të ardhurat buxhetore me dy shifra, domethënë, mbi 10 miliardë dollarë në vit.

Por nga ana tjetër kisha disa pyetje, sidomos me koncesionet në Shëndetësi. Nisur edhe nga shqetësimi publik më shumë për instrumentet e kompanisë që e ofron këtë shërbim. Janë dhënë në kohëzgjatje prej 3 vjetësh 3 shërbime, check up-i, ofrimi i shërbimit të dializës si dhe ofrimi i shërbimit të integruar, po përgatitet edhe ofrimi i shërbimit laboratorik nëpër spitale. Me të drejtë, edhe kolegja ime e përmendi, po e përsëris pyetjen: në qoftë se në investimet e tjera, në finale, publikut, shtetit u mbetet si aset i kapitalizuar inceneratori, rruga apo diçka tjetër, po këtu çfarë u mbetet këtyre kompanive pasi kanë dhënë shërbimet e tyre në këto fusha publikut dhe si aset shtetëror, sepse check up-et bëhen, pasi nuk dihen adresat e laboratorëve, ka dyshim për cilësinë e verifikimit cilësor; përdorin ambientet që kanë marrë me qira...

Erion Braçe – Zoti Beqiraj, pyetjen të lutem!

Ismet Beqiraj – Pra, çfarë i mbetet si aset i kapitalizuar? Lidhur me shqetësimin që ju thatë për sa i përket koncesionit doganor për skanimin, a ekziston mundësia e shfuqizimit të kësaj kontrate, që të mos i mbetet popullit si një gur borxhi mbi qafë? Ju na thatë që së shpejti po përgatitet një projektligj për koncesionet për heqjen e propozimeve të pakërkuara,

si dhe për heqjen e bonusit, a jeni i mendimit se në këtë projektligj çdo kontratë koncensionare do të ratifikohet në parlament?

Së fundi, kompanitë që marrin të gjitha këto kontrata me partneritet privat-publik, a kanë edhe monopolin e projektit të këtyre investimeve? Strukturat e shtetit nuk bëjnë certifikimin, sidomos të projektit, sepse projekti duhet të verifikohet dhe të kontrollohet vazhdimisht?

Faleminderit!

Arben Ahmetaj – Po filloj nga pyetja e fundit. Në procedurë nëse...

Ismet Beqiraj – Zoti Ahmetaj, e bëra këtë pyetje sepse këtu para kam edhe vlerën e kostos për kilometër të akseve që jepen, por e krahasuar me vendet si Austria, Hungaria, Danimarka dhe Kroacia, unë po mbledh buzët me thënë të drejtën.

Arben Ahmetaj – Faleminderit!

Pra, po nisem nga pyetja juaj e fundit. Siç e theksova, sepse ju sollët një shembull në infrastrukturë, ajo që ndodh në infrastrukturë ose ajo që ndodh në një proces të një koncesioni ose të një partneriteti publik – privat është: nëse ka ardhur një ofertë e pakërkuar, sepse kur është e kërkuar nuk kemi nevojë që ta bëjmë këtë diskutim, praktikisht vlerësohet projekti dhe ky projekt pronësohet nga shteti në këmbim të bonusit. Pra, i gjithë projekti i ofertuesit të pakërkuar pronësohet dhe kur pronësohet kalon në filtrat e besimit. Për shembull, projektet e infrastrukturës, nga ofertues të pakërkuar në procesin e pronësimit, në këmbim të bonusit kalojnë gjithë procesin e vlerësimit brenda ARRSH-së dhe kalojnë në komitetin teknik, ku vlerësohen kostot qoftë nga ana e volumit, qoftë komplekset e inxhinierive të asociuara me kostot. Pyetja e dytë ishte: çfarë i mbetet shtetit? Shtetit i mbetet investimi.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Më falni!

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Unë bëra një referim të benefiteve dhe shtetit, përveçse i mbetet investimi, gjithashtu ne bëjmë të mundur edhe shpëtimin e qindra jetëve njerëzish nga sëmundje. Unë jo pa qëllim iu referova standardit të NHS-së, NHS-ja është Shërbimi Kombëtar i Kujdesit Shëndetësor në Britaninë e Madhe dhe me standard iu referova disa shifrave, që me kënaqësi po jua rithem. Në mos gabohem janë shpëtuar 450 jetë njerëzish dhe janë kursyer rreth 125 milionë dollarë nga parandalimi i sëmundjeve. Shifra e saktë bazohet në të dhënat që vijnë nga përvoja botërore dhe nga analiza kosto për fitime të NHS-së, *National Health Service*, që është Shërbimi Kombëtar i Kujdesit Shëndetësor në Angli, të vendosura në kontekstin shqiptar ne atë filtrim që i bëjmë nëpërmjet *Proces Paver Parity*, por kjo për këtë sekondë

nuk ka vlerë. Rezulton se me programin e kontrollit bazë pa pagesë 40 deri në 65 vjeç do të arrihet të kursejmë kosto për shpenzime shëndetësore rreth 15,4 miliardë lekë ose 125 milionë dollarë në 10 vjet, si dhe parandalohen 450 vdekje të parakohshme, përveç se i gjithë investimi i mbetet shtetit.

Pyetja tjetër ka lidhje me skanimin. Për sa i përket skanimit, ne e provuam në vitin 2014 të futeshim në një proces legal të prishja e kontratës dhe nga parashikimet që bëri Avokati i Shtetit në lidhje edhe me avokatët ndërkombëtarë që e ndihmonin i shkonte kostoja e prishjes rreth 280 milionë dollarë. Kështu që vendosëm që të paktën të ulnim koston e një deklarate nga 39 euro në 22 euro , që ishte kostoja e biznesit, dhe morëm përsipër të gjitha deklaratat doganore për import –eksport të fasonëve dhe të një pjese tjetër të një kategorie të caktuar të biznesit që na kushton vetëm në vitin 2019 1,9 miliardë. Pra, buxheti i shtetit do të paguajë 1,9 miliardë, përveç asaj që do të paguajë edhe biznesi, pra kostot e një kontrate koncensionare. Këto ishin pyetjet, apo jo?

Ismet Beqiraj – Kisha edhe një pyetje lidhur me opinionin tuaj për ndryshimet ligjore?

Erion Braçe – Kur të vijmë te ligji, sepse nuk e kemi tani në diskutim ligjin, atëherë do ta diskutojmë.

A ka pyetje të tjera? Nuk ka. A ka diskutime? Nuk ka.

Atëherë, për ta mbyllur këtë pikë të rendit të ditës, së pari, dua të theksoj se partneriteti publik-privat është një instrument shumë i qartë ligjor, jo kombëtar, por përtej të qenit kombëtar, është një instrument i qartë dhe ekonomik. Kushdo që aludon duke përmendur këtë instrument ekonomik dhe ligjor si një instrument kriminal, natyrisht është jashtë kohe, jashtë vendit dhe nuk përputhet as me ligjin dhe as me atë që edhe gjatë kësaj seance u referua në mënyrë të qartë si përvojë europiane dhe më gjerë se atë.

Së dyti, edhe propozimi i pakërkuar, për të cilin ka një betejë të vijueshme mbështetur mbi të pavërtetat, mbi abuzimet është një formë e parashikuar në ligj dhe ky aspekt i ligjit nuk ka ndryshuar që nga momenti që doktor Sali Berisha, me idetë e tij për partneritetin publik – privat u jetësuan në ligj dhe u miratuan në Kuvendin e Republikës së Shqipërisë. Pa asnjë lloj diskutimi, ka një çështje që lidhet drejtpërdrejt me propozimin e pakërkuar si formë e partneriteti publik – privat. Natyrisht, unë mendoj se është momenti, është koha që ne ta adresojmë këtë shqetësim jo vetëm kombëtar, por edhe ndërkombëtar në raport me këtë formë që deri tani është legale e partneritet publik-privat. Unë mendoj se me ligjin e ri për koncensionet dhe partneritetin publik-privat do të konsumojmë të gjithë

debatin dhe natyrisht edhe propozimet më të mira për t'i dhënë fund kësaj forme në sektorë të ndryshëm të ekonomisë së vendit. Për mua personalisht edhe te sektori i energjisë elektrike.

Së treti, dua të theksoj se është bërë një hap shumë i rëndësishëm përpara për sa i përket transparencës së kontratave të partneritetit publik –privat dhe koncesioneve. Është e vërtetë ajo që thotë ministri, që për herë të parë kemi një regjistër të koncesioneve dhe të partneritetit publik –privat. Por në rast se mbetemi këtu te regjistri, unë mendoj se nuk kemi bërë ende gjënë e duhur. Do të duhet që ky regjistër të jetë i aksesueshëm me të gjitha detajet e tij, përfshirë kontratën, detyrimet buxhetore përkundrejt saj apo private përfshirë një zë të posaçëm. Investimet te secila kontratë parashikojnë një raport me shërbimin publik apo veprën që do të ndërtojë dhe në fund fare pse jo të gjithë dosjen e konkurrimit deri në mbërritjen e një kontrate finale të nënshkruar nga palët. Pra, zgjerimi i transparencës në raport me një kontratë të partneritetit publik- privat për mua është i domosdoshëm. Unë mendoj se autoritet e kanë mundësinë që të bëjnë të gjithë transparencën maksimale të mundshme për secilën nga kontratat koncesionare dhe të partneriteti publik-privat. Gjithsecili të ketë akses në këto dokumente dhe gjithsecili të ndihmohet për të bërë krahasimin ndërmjet asaj që është e vërtetë dhe asaj që është e rreme, asaj që ka ndodhur në këtë periudhë dhe asaj që ka ndodhur në periudha të ndryshme, referuar qeverive të ndryshme që kanë kaluar në pushtet dhe kanë përdorur këtë instrument për arsye nga më të ndryshmet qofshin këto shërbime, por edhe investime publike.

Së katërti, ajo që mua më intereson ta them është se beteja përkundrejt disa kontratave të partneritetit publik-privat, ndërmarrë në harkun e dy apo tre vjetëve me shifra të rreme apo me argumente të rreme, natyrisht që mund të zhvillohet, mund ta vijojmë ta bëjmë, por pa shkaktuar dëme në qëllimin kryesor të kontratave të partneritetit publik- privat. U referohem në mënyrë të qartë kontratave të partneritetit publik- privat në sektorin e shëndetësisë. Po jap vetëm një të dhënë Kostoja vjetore buxhetore e këtyre kontratave arrin në 3 miliardë lekë kur i gjithë buxheti i shëndetësisë është 50 miliardë lekë dhe të tria kontratat ofrojnë shërbim jo vetëm në funksion të parandalimit, por edhe të kurimit, siç janë edhe kontratat e instrumenteve të sterilizimit të tyre, sallave, pse jo edhe të mjekëve që futen në ato salla apo kontratat e ofrimit të shërbimit të dializës për qytetarët.

Pra, edhe njëherë nuk arrin as 6% të buxhetit vjetor të shërbimit shëndetësor në këtë vend. Natyrisht, përfitimet kanë qenë të mëdha, por këtu vijmë te një pikë që kolegët e mi e ngritën me shumë të drejtë deri më sot zoti Ministër, nuk ka asnjë analizë që të tregojë përfitimet maksimale që kanë marrë nga të tria kontratat e partneritetit publik- privat, nuk ka as analizë sektoriale, nuk ka as analizë të vetë kompanive. Do të duhet që gjithkush të bjerë

në kontakt me mjekë në qendra universitare apo edhe në spitale rajonale për të kuptuar efektin pozitiv që ka pasur partneriteti publik- privat në fushën e sterilizimit të instrumenteve dhe, natyrisht, të sallave të operacioneve, veçanërisht infeksionet operatore dhe postoperatore dhe efektet që burojnë pastaj nga kurimi i këtyre infeksioneve, që në kohë të ndryshme kanë marrë edhe jetë njerëzish. Kështu që lind detyra t'ia themi nesër edhe Ministrisë së Shëndetësisë që në mënyrë urgjente ky Kuvend, por edhe opinionin publik të ketë një analizë të qartë pikërisht të efekteve pozitive që këto kontratat kanë sjellë. Kur them këtë vazhdoj të insistoj në atë pikë, për të cilën ju pyeta do të duhet që këto kontrata të monitorohen kjo vetëm në aspektin formal të tyre, qoftë edhe fiskal, siç e keni ju detyrë për ta monitoruar këtë gjë, por edhe në aspektin e produktiviteti të tyre. Në rast se ne po shkojmë drejt 3 kontratave njëra në zbatim dhe dy të tjerat në ndërtim e sipër në fushën e mjedisit dhe natyrisht po shpenzojmë dy herë më shumë se sa buxheti i mjedisit. Në qoftë se buxhetin e mjedisit e kemi 1,1 miliardë si funksion, 2,1 miliardë shkojnë pagesa në vit.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Unë po bëj një krahasim tjetër, zoti Ministër!

Në qoftë buxheti i mjedisit në buxhetin e shtetit si funksion shkon 1,1 miliardë, natyrisht në këtë pikë ku ne po investojmë, për të ndikuar drejtpërdrejt në mjedis, pse jo edhe në shëndetin e qytetarëve nesër, po shpenzojnë dyfishin e kësaj shume dhe po shkojmë diku te 2,1 miliardë në vit. Natyrisht që duhet të marrim maksimumin e mundshëm nga produkti i këtyre kontratave të partneritetit publik- privat. Prandaj insistova edhe më herët. Në qoftë se ne kemi një kontratë të partneritetit publik- privat në Elbasan për menaxhimin e mbetjeve, duhet që t'u japim fund pikave të grumbullimit të mbetjeve nëpër rrëpira në dalje fshatrash, në hyrje fshatrash, në rrugë nacionale, buzë lumenjve e të tjera me radhë.

Në rast se kjo nuk bëhet me vullnet, duhet bërë me detyrim përkundrejt bashkive që kanë marrë në administrim edhe këtë funksion të rëndësishëm të menaxhimit të mbetjeve urbane, sidomos tani që kemi të bëjmë me njësi shumë më të mëdha se sa një komunë e veçuar atje matanë. Pra, të eliminojmë këto pika të zeza nga territoret ku ne po adresojmë me politikën tonë, pra me politikën e menaxhimit të integruar të mbetjeve këtë problematikë. Pra, në qoftë se ne paguajmë për këtë çështje, po paguajmë për çështjen e inceneratorëve dhe ju thashë nuk paguajmë pak, por paguajmë shumë, duhet të marrim maksimumin e mundshëm nga kjo gjë.

Së pesti, ajo që mua më shqetëson te koncesionet ndërtuese, të cilat më lejoni t'ju them se duhen mbështetur në maksimum, është elementi i kostos që është kthyer në një debat propagandistik publik dhe që më pas godet edhe më shumë opinionin publik. Duhet që të jetë

transparencë e plotë për kostot, zoti Ministër. Këtë që ne dhe ju bëmë sot këtu do të duhet që ministritë e linjës, agjencitë, siç është edhe Autoriteti Rrugor Shqiptar, ta bëjë publikisht në dokumente, me qëllim që askush të mos abuzoj pikërisht me këtë fakt, por para se të arrijmë këtu, duhet që të ndodhë ajo që edhe FMN-ja ka kërkuar , theksuar dje edhe nga Guvernatori i Bankës së Shqipërisë, që ju të rrisni kapacitetet vlerësuese, jo juve personalisht, por ministria e linjës dhe Ministria e Ekonomisë dhe Financave, pikërisht të propozimeve që janë sot disponibël në zyrat e shtetit shqiptar. Ju duhet të bëni përputhjen në standard për secilën kontratë të çmimeve dhe të kostove totale të këtyre projekteve , ju duhet të garantoni gara të hapura, të ndershme dhe të vërteta, ku vërtet ai që ka bërë propozimin të futet dhe të konkurrojë me gjithë të tjerët, me qëllim që ne më pas, të interesuarit publikë, të marrim edhe çmimin më të mirë, edhe koston më të mirë, edhe cilësinë më të mirë në harkun e këtyre vjetëve që do të ndërtohet dhe do të mirëmbahet vepra. Është shumë e rëndësishme kjo pjesë për ne.

Së gjashti, natyrisht që vazhdoj të insistoj te çështja e koncesioneve në energjinë elektrike, sepse është një element shumë i rëndësishëm dhe në dijeninë time ka të tjera që vijnë dhe janë rrugës. A nuk u shterka ky interes për të ndërtuar hidrocentrale shumë të vogla në këtë vend?! Natyrisht, tani do e kemi ligjin para dhe do ta bëjmë këtë diskutim, por tani është koha që ne të zgjedhim , duam një zhvillim të kontrolluar që i jep forcë dhe fuqi ekonomisë së gjelbër dhe interesit publik të banorëve të atyre territoreve, apo thjesht dhe vetëm duam të përmbushim interesin e një individi, që kërkon të shpenzojë paratë e tij këtu, por i subvencionuar në fund fare për produktin e tij, pra që do të përfitojë maksimalisht nga kjo gjë. Kështu që unë do të doja një analizë të qartë pranë këtij komisioni të të gjitha kostove që ne na burojnë nga ato 280 e kusur kontrata në energji elektrike, në funksion të idesë së çmëndur për ta kthyer këtë vend në një superfuqi energjetike, u tha në atë kohë dhe që, natyrisht, ka sjellë pasoja kolosale në mjedisin e këtij vendi, të cilat ne i vëmë re në momentin më të parë që rastisim apo biem në një vit të thatë nga pikëpamja e reshjeve, komunitete të tëra që kanë nevojë për burime ujore të atyre që i kanë gëzuar për vite me radhë dhe që tashmë nuk i kanë më.

Së fundi, dua ta mbështes vëzhgimin apo orientimin e Guvernatorit të Bankës së Shqipërisë dje. Duhet të qëndrojmë në kontratat e të partneritetit publik- privat, që janë brenda strategjisë së qeverisë. Pra, të shkojmë dhe të përputhim strategjinë me qëllimet dhe natyrisht me kontratat në fund fare dhe të mos dalim përtej tyre, me qëllim që të marrim maksimumin e mundshëm nga instrumentet ekonomike, të dimë se si po e zhvillojmë këtë proces, ta kemi nën kontroll dhe në fund fare të dimë edhe se me kë kemi të bëjmë.

Pa asnjë lloj diskutimi, unë për herë të dytë po e vlerësoj hartimin e një regjistri ku janë të listuara të gjithë kontratat koncesionare dhe të partneritetit publik privat. Por, kur them të dimë se me kë kemi të bëjmë, kam parasysh që ende sot nuk e dimë se kush është pas kontratës koncesionare të markimit të karburanteve, si individ nëse doni, nuk dimë se kush është pas kontratës koncesionare të pullave fiskale dhe pas kontratës koncesionare të skanimit të kontejnerëve. Në momentin që ne arrijmë të zbardhim këtë, nuk do të ketë nevojë për investigime të mëtejshme për pronësinë e individëve mbi këto kontrata.

Për ta mbyllur, zoti Ministër, do të doja që qeveria të bëhet gati edhe për kontratat që janë në fund të afatit të tyre. Vitin e ardhshëm fillon skedimi për kontratat koncesionare dhe ne duhet të dimë se ç'do të bëjmë më tutje, që ta adresojmë këtë problematikë, duke ditur që këto kontrata kanë operuar në kushte monopoli. Për shembull, po i referohem kontratës koncesionare të kontrollit teknik të automjeteve, e cila është në skadim të afatit dhe ne duhet të mendojmë për shërbimin, për kostot, si edhe për radhët kilometrike që vijnë si pasojë e moszbatimit të vetë kontratës dhe jo më të vendimit për ta kthyer këtë shërbim në një monopol të një privati. Prandaj do të duhet të mendojmë edhe për elementin që buron nga kontrata, pra fundin e këtyre kontratave dhe çfarë do të bëhet me këto shërbime më tutje.

Kjo pikë mbyllet këtu.

Faleminderit!

MBYLLET MBLEDHJA



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI
Komisioni për Ekonominë dhe Financat

PROCESVERBAL

Tiranë, më 20.11.2018, ora 12:00

Drejton mbledhjen:

Erion Braçe – kryetar i Komisionit

Rendi i ditës:

1. Shqyrtimi i raporteve, në parim, të komisioneve të përhershme të Kuvendit për projektligjit “Për buxhetin e vitit 2019” dhe projektligjeve financiare që shoqërojnë atë.
2. Miratimi në parim i projektligjit “Për buxhetin e vitit 2019” dhe projektligjeve financiare që shoqërojnë atë.

Marrin pjesë:

Erion Braçe, Anastas Angjeli, Evis Kushi, Antoneta Dhima, Ilir Xhakolli, Xhevit Bushaj, Arben Pëllumbi, Roland Xhelilaj, Reme Lala, Ismet Beqiraj dhe Sadi Vorpsi.

Mungojnë:

Jorida Tabaku, Blerina Gjylameti, Ervin Bushati Edmond Spaho, Agron Shehaj, Fatbardha Kadiu, Nadire Meçorapaj, Dashamir Shehi, Edmond Haxhinasto dhe Përparim Spahiu.

Të ftuar:

Arben Ahmetaj – Ministër i Financave dhe Ekonomisë

Gelardina Prodani- Sekretare e Përgjithshme në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë

Mimoza Dhëmbi – Drejtore e Përgjithshme në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë

Gentian Opre – Drejtor në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë

Xhoana Agolli – Drejtore në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë

Alda Klosi – Drejtor i koncesioneve në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë

Alba Caroshi – Këshilltare në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë

Arber Lleshi - Këshilltar në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë

Knidi Bashari – Këshilltar në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë

Erion Braçe – Kalojmë në votimin në parim të projektligjit të buxhetit të shtetit dhe të ligjeve të paketës fiskale.

Në këtë proces do të administrojmë edhe raportet e komisioneve të përhershme të Kuvendit në lidhje me diskutimet që kanë zhvilluar për projektbuxhetin e vitit 2019.

Së pari, Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtën e Njeriut ka shqyrtuar projektbuxhetin dhe thotë: “Në përputhje me afatet e përcaktuara në kalendarin e Kuvendit, sipas nenit 79 të Rregullores, për shqyrtimin e projektligjit të buxhetit të shtetit, bazuar në nenin 80 të Rregullores së Kuvendit, paraqet këtë raport në komisionin përgjegjës, dhe ka votuar “pro” projektbuxhetin e shtetit për vitin 2019”. Në këtë raport ka edhe propozime që kanë të bëjnë me miratimin nen për nen të buxhetit të shtetit për vitin 2019, por edhe për ligjet fiskale,

Së dyti, Komisioni për Veprimtarinë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin ka diskutuar në disa seanca projektbuxhetin e shtetit për vitin 2019. Edhe ky komision, pas votimit me shumicë votash të deputetëve të pranishëm të projektbuxhetit të shtetit për vitin 2019, ka arritur në konkluzionin që projektbuxheti i shtetit duhet mbështetur në parim

Komisioni për Punët dhe Çështjet Sociale ka diskutuar në disa seanca projektbuxhetin e viti 2019 dhe i sugjeron Komisionit të Ekonomisë dhe Financave miratimin në parim të projektligjit, pas votimit me shumicë votash në këtë komision.

Komisioni Parlamentar për Integrimin European ka shqyrtuar e ka votuar projektbuxhetin e shtetit për vitin 2019 dhe i sugjeron këtij komisioni miratimin në parim të tij.

Komisioni për Politikën e Jashtme ka shqyrtuar projektbuxhetin dhe me shumicë votash e ka votuar atë në parim dhe i sugjeron Komisionit për Ekonominë dhe Financave miratimin e tij.

Komisioni për Politikën e Jashtme ka bërë propozime që lidhen me diskutimin nen për nen të buxhetit të shtetit për vitin 2019, sipas ministrive që mbulon.

Komision për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik ka bërë të njëjtën gjë, ka analizuar projektbuxhetin në disa seanca sipas sektorëve që mbulon dhe në fund e ka votuar atë me shumicë votash. Ky komision sugjeron votimin në parim të projektbuxhetit të shtetit për vitin 2019.

Komisioni për Arsimin dhe Median ka bërë propozimet që i korrespondojnë shqyrtimit nen për nen të projektbuxhetit të shtetit për viti 2019.

Edhe Komisioni për Sigurinë Kombëtare ka bërë shqyrtimin e buxhetit të shtetit sipas dikastereve respektive dhe e ka votuar në parim atë, duke ia kaluar Komisionit për

Ekonominë dhe Financat kërkesën e tij për miratimin e projektbuxhetit të shtetit për vitin 2019.

Pas administrimit të këtyre raporteve, kalojmë drejtpërdrejtë në votim në parim.

Kush është kundër?

Zoti deputet jemi në parim

Ismet Beqiraj – E di që jemi në parim, por dua të sqaroj diçka. Unë si deputet, por edhe si anëtar zëvendësues i këtij komisioni ju kam dërguar një memo. Përpara se ta kalojmë në parim lidhur me investimet që kam kërkuar...

Erion Braçe – Dakord. Po ju them edhe një herë tjetër që jemi në votimin në parim. Unë e kam marrë letrën tuaj dhe ia kam paraqitur sekretarisë së komisionit, e cila do të diskutohet në momentin që ne të fillojmë diskutimin nen për nen të projektbuxhetit të viti 2019

Ismet Beqiraj – Këtë përgjigje doja.

Erion Braçe – Hedhim në votim projektligjin për buxhetin e shtetit për vitin 2019”. Kush është dakord? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet në parim projektbuxheti i shtetit për vitin 2019.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI
Komisioni për Ekonominë dhe Financat

PROCESVERBAL

Tiranë, më 20.11.2018, ora 12:00

Drejton mbledhjen:

Erion Braçe – kryetar i Komisionit

Rendi i ditës:

Miratimi në parim i projektligjeve financiare që shoqërojnë projektligjin “Për buxhetin e vitit 2019”

Marrin pjesë:

Erion Braçe, Anastas Angjeli, Evis Kushi, Antoneta Dhima, Ilir Xhakolli, Xhevit Bushaj, Arben Pëllumbi, Roland Xhelilaj, Reme Lala, Ismet Beqiraj dhe Sadi Vorpsi.

Mungojnë:

Jorida Tabaku, Blerina Gjylameti, Ervin Bushati Edmond Spaho, Agron Shehaj, Fatbardha Kadiu, Nadire Meçorapaj, Dashamir Shehi, Edmond Haxhinasto dhe Përparim Spahiu.

Të ftuar:

Arben Ahmetaj – Ministër i Financave dhe Ekonomisë

Gelardina Prodani- Sekretare e Përgjithshme në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë

Mimoza Dhëmbi – Drejtore e Përgjithshme në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë

Gentian Opre – Drejtor në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë

Xhoana Agolli – Drejtore në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë

Alda Klosi – Drejtor i koncesioneve në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë

Alba Caroshi – Këshilltare në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë

Arber Lleshi - Këshilltar në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë

Knidi Bashari – Këshilltar në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë

Erion Braçe –Kalojmë në votimin e neneve të projektligjeve që shoqërojnë buxhetin e shtetit për vitin 2019.

Së pari, për ligjin për tatimin mbi vlerën e shtuar, të ndryshuar, në Republikën e Shqipërisë në parim. Kush është pro? Kundër? Abstenim? Nuk ka.

Miratohet në parim projektligji për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë, i ndryshuar.

Projektligji për miratimin e niveleve të tarifës doganore, i ndryshuar. Kush është pro? Kundër? Abstenim? Nuk ka.

Miratohet edhe ky projektligj në parim.

Projektligji për akcizat në Republikën e Shqipërisë, i ndryshuar. Kush është pro? Kundër? Abstenim? Nuk ka.

Miratohet edhe projektligji për akcizat në Republikën e Shqipërisë në parim.

Projektligji për tatimin mbi të ardhurat, të ndryshuar. Pro? Kundër? Abstenim? Nuk ka.

Miratohet projektligji për tatimin mbi të ardhurat, i ndryshuar.

Projektligji për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë, të ndryshuar. Kundër? Pro? Abstenim?

Miratohet në parim projektligji për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë.

Projektligji për taksat kombëtare, i ndryshuar. Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet projektligji për taksat kombëtare, i ndryshuar, në parim.

Projektligji për sistemin e taksave vendore, i ndryshuar. Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet projektligji për sistemin e taksave vendore, i ndryshuar, në parim.

Këtu i japim fund fazës së parë të diskutimit të projektbuxhetit dhe projektligjeve financiare, që e shoqërojnë atë.

Projektligjet dhe projektbuxheti do të diskutohen në seancë plenare ditën e enjte në parim dhe pas votimit në Kuvend do të kalojnë në diskutimin nen për nen të projektligjeve financiare, që shoqërojnë buxhetin e shtetit në javët në vijim.

Komisioni fillon nesër seancën dëgjimore me ministrat e sektorëve prioritarë të buxhetit të shteti dhe pastaj me grupet e interesit. Nesër në seancë dëgjimore do të jetë ministri i Infrastrukturës dhe ai i Bujqësisë. Ditën e premte do të jetë i ftuar ministri i Shëndetësisë dhe ai i Arsimit, ndërsa ditën e hënë do të jenë grupet e interesit, kryesisht Dhoma e Tregtisë dhe ditën e martë kemi shqyrtimin nen për nen të projektligjeve të paketës fiskale dhe të buxhetit të shtetit.

Mbledhja mbyllet këtu.

Faleminderit!

MBYLLET MBLEDHJA